



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.12.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për programin e shkëmbimit akademik “Fulbright”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Damian Gjikhuri, Bashkim Fino, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Përmeti, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti, Alban Zeneli, Ediola Braha, Nikolin Staka dhe Artemisa Malo

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Elton Haxhi- Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera- Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Fiskale
Doriana Toro – specialiste në Drejtorinë e Përgjithshëm të Politikave Makroekonomike dhe Fiskale

Ilda Koja – Drejtoreshë e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Kostandin Shkurti- Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Erzen Tola- Drejtor i Përgjithshëm Rregullator dhe i Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë.

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja- Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Pas një ndërprerjeje të gjatë për shkak të asaj fatkeqësie natyrore që goditi qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, unë gjej rastin që në emrin tim dhe të të gjithë kolegëve të mi të komisionit të shpreh ngushëllimet e sinqerta për 51 jetët e humbura, për afro 1000 të lënduar, por edhe për mijëra të tjerë, që sot janë pa një strehë, si dhe të garantoj mbështetjen e Komisionit të Ligjeve që procesi i rindërtimit të banesave, por dhe i rehabilitimit të të gjithë personave dhe familjeve, që sot janë pa strehë, të bëhet në një kohë sa më të shpejtë.

Sot, në fakt, kemi një rend dite të ngjeshur. Pikë të parë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe relatore është kolegja Elena Xhina. Prezent nga Ministria e Financave kemi zotin Elton Haxhi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë; zotin Nikolla Lera, drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Fiskale, dhe zonjën Doriana Toro, e cila është në të njëjtën drejtori. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve prezent kemi zonjën Ilda Koja, drejtoreshë e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike.

Zoti Haxhi, së bashku me stafin që ju shoqëron, mirë se erdhët në komision!

Ju lutem, një prezantim të shkurtër të këtij projektligji për kolegët e komisionit. Pastaj fjalën e ka relatorja, zonja Xhina, dhe kolegët për pyetje dhe diskutime.

Elton Haxhi – Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kemi sjellë për miratim projektligjin “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, i cili është si përmbushje e detyrimeve që vendi ka marrë me ratifikimin e Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellët në Çështjet Tatimore, e cila është miratuar me ligjin nr.146/2013, datë 06.05.2013. Në vijimësi është miratuar marrëveshja shumëpalëshe e autoriteteve kompetente për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare, e miratuar me VKM-në nr. 178/2016. Kjo VKM parashikonte që shkëmbimi automatik i informacionit për llogaritë financiare të fillonte në vitin 2018, por për

shkaqe objektive është kërkuar një shtyrje deri në vitin 2020, në mënyrë që të përgatitet e gjithë infrastruktura e nevojshme për shkëmbimin e këtij informacioni dhe është miratuar. Pra, jemi në kohë për të miratuar këtë projektligj, në mënyrë që në vitin 2020 të fillojë ky shkëmbim. Ku konsiston ky shkëmbim?! Të gjitha subjektet raportuese, që janë institucionet financiare, bankat e nivelit të dytë, që mbajnë llogari të personave individë apo subjekteve juridike janë të detyruara të mbledhin informacionin që lidhet me individë të huaj, jorezidentë në Shqipëri, apo me kompani që kanë pronësi të huaj dhe këtë informacion ta shkëmbejnë sipas një standardi të rënë dakord nga organizata e OECD-së, e cila do të bëjë të mundur shkëmbimin e informacionit me çdo vend sipas rezidencës të secilit subjekt juridik apo individ. Nga ana tjetër, edhe vendi ynë, autoriteti kompetent, që është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, do të marrë të njëjtin informacion për të gjithë shtetasit shqiptarë, të cilët kanë llogari bankare në këto vende dhe janë pjesë e kësaj marrëveshjeje. Llogaritë apo informacioni që shkëmbehet ka lidhje vetëm me llogaritë bankare dhe përfshin gjendjen e llogarive, interesat e përfituara, dividendët e përfutur dhe fitime nga shitja e aktiveve apo pasurive, të cilat kalojnë nëpërmjet këtyre llogarive bankare. I gjithë ky informacion, i grupuar sipas çdo vendi, do të transmetohet me autoritetin kompetent të atij vendi dhe Shqipëria do të marrë të njëjtin informacion.

Në projektligj është parashikuar që bankat kanë afat deri më 30 maj të vitit 2020 për të kryer vigjilencën e duhur për të mbledhur të gjithë informacionin e nevojshëm se kush janë individët subjekt të raportimit, ta mbledhë këtë informacion dhe ta transmetojë tek autoriteti kompetent, që është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Ai ka afat deri më 30 shtator të viti 2020 që këtë informacion ta shkëmbejë me autoritetet kompetente, që janë pjesë e kësaj marrëveshjeje. Data efektive e mbledhjes së informacionit është data 01.01.2019. Pra, pavarësisht se informacioni po shkëmbehet në shtator të këtij viti, të vitit të ardhshëm 2020, informacioni do të përfshijë të gjitha lëvizjet, pra interesat, dividendët apo fitimet nga shitja e pasurive që nga janari i vitit 2019. Janë rreth 100 vende që janë pjesë e kësaj marrëveshjeje, të cilat e kanë nënshkruar marrëveshjen për shkëmbimin automatik të informacionit për llogaritë financiare. Përveç vendeve të Bashkimit Europian, që janë pjesë e kësaj marrëveshjeje, ka edhe shumë vende, të cilat janë konsideruar si parajsë offshore, të cilat do të jenë të detyruara të shkëmbejnë informacion me autoritetin kompetent, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Haxhi!!

Zonja Xhina, fjala për ju.

Elena Xhina – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit përfaqësuesve të ministrisë për relatimin dhe parashtrimin që na bënë lidhur me projektligjin!

Komisioni ynë është komisioni për dhënie mendimi dhe, duke iu referuar neneve 32 dhe 38 të Rregullores, ne e shqyrtojmë atë sot në parim.

Nevoja për këtë ndërhyrje ligjore ka lindur nga nënshkrimi i marrëveshjes model shumëpalëshe të autoriteteve kompetente, në zbatim të nenit 6 “Shkëmbimi automatik i Informacionit” të Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore, që siç e referuan edhe zotërinjtë, Shqipëria e ka miratuar me ligjin nr. 146, datë 06.05.2013. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje e angazhon Shqipërinë për zbatimin e shkëmbimit automatik të informacionit në fund të vitit 2018 dhe, siç e thashë, është kërkuar për ta shtyrë, në mënyrë që të krijohet baza ligjore për këtë transportim të të dhënave.

Aktualisht, në vendin tonë mungon një kuadër rregullator në fushën e shkëmbimit automatik të informacionit dhe krijimi i një kuadri të ri ligjor do të ndihmojë në çrrënjosjen e krimit të evazionit fiskal dhe trajtimin e mashtrimit fiskal. Nëpërmjet shkëmbimit automatik të informacionit, në rastet e konstatimit të evazionit fiskal, merren masat për parandalimin dhe shmangien e tij. Në situatën aktuale, mungesa e një kuadri rregullator bën të mundur zvogëlimin e të ardhurave publike, dobësimin e besimit të drejtësisë në sistemin tatimor dhe rritjen e barrës mbi tatimpaguesit e ndershëm. Referuar kuadrit ligjor dhe dispozitave që përmban sot projektligji i ardhur për miratim, mendohet që mund të ndërhyjë dhe t’i rregullojë këto problematika.

Nuk po ndalem te qëllimi dhe përmbajtja e dispozitave, pasi e keni projektligjin përpara dhe pak a shumë u përmenden nga përfaqësuesit e ministrisë.

Në datën 13.11.2019 Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut i është drejtuar Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi, siç e thamë, dërgohen informacione lidhur me të dhëna sensitive për individë të ndryshëm apo shoqëri dhe menduam që kjo ishte pjesa kryesore për t’u parë nga ky komision. Komisioneri na informoi se ky projektligj është dërguar për mendim edhe nga vetë Ministria e Financave dhe ka rezultuar se Komisioneri i gjen të reflektuara të gjitha sugjerimet e dhëna lidhur me këtë projektligj në projektligjin që ne kemi sot kemi për diskutim.

Në përfundim, në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe, në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Në parim vlerësoj që ne ta miratojmë atë, por, duke u nisur nga relatiimi, dua të bëj një pyetje. Ju thatë që efektet do të fillojnë në janar të vitit 2019, a e keni parashikuar në ligj se kur fillojnë efektet, sepse unë nuk e pashë në dispozita?

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Xhina!

Elton Haxhi – Neni 6, pika e parë e tij, e përcakton që mbledhja dhe vetëdeklarimi për llogaritë financiare të hapura fillon nga 1 janari i vitit 2019 e në vijim...

Ulsi Manja- Jo, nuk është në nenin 6.

Elton Haxhi- Te neni 6 është te verifikimi i duhur, ku thuhet: “Bankat janë të detyruara të fillojnë verifikimin nga 1 janari”.

Dispozita kalimtare, neni 18, e përcakton që raportin brenda datës 30 maj të vitit 2020 për të gjitha llogaritë e raportueshme ekzistuese në datë 01.01.2019.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Haxhi!

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Falënderoj përfaqësuesit e ministrisë!

Unë dua të kuptoj diçka, por duhet ta kuptojnë edhe publiku, edhe deputetët. Ju thoni që ne e kemi ratifikuar dhe kemi bërë një ligj në vitin 2013, 06.05.2013, madje pas këtij ligji ka dalë edhe një vendim qeverie në vitin 2016, ai me numër 178, datë 09.03.2016, i cili do të fillonte të livronte pikërisht këtë shkëmbim automatik të informacionit financiar, por, siç e tha zëvendësministri, kjo u shty për vitin 2018, nëse nuk gabohem...

Elton Haxhi –Jo, nga viti 2018 në vitin 2020.

Bashkim Fino- Dakord. Sot na sillni një ligj të ri dhe unë dua të di çfarë ka ndryshuar nga ratifikimi dhe nga ligji i vitit 2013 me projektligjin që vjen sot në vitin 2019 dhe hyn në fuqi në vitin 2020? Kjo është pjesa kryesore dhe më e rëndësishme.

Së dyti, ajo që tha edhe zonja Xhina, në qoftë se ne miratojmë një ligj të ri, pra abrogojmë ligjin e vjetër të vitit 2013 dhe bëjmë ligjin e ri, do të thotë që fuqia prapavepruese nuk ka vlerë, ajo ka fuqi në momentin që ne miratojmë ligjin. Pra, nëse ne e bëjmë këtë ligj që në janar të vitit 2020 të jetë efektiv, do të thotë që nga viti 2020 çdo gjë do të jetë e shkëmbyeshme midis vendeve të ndryshme që e kanë ratifikuar, ku janë 100 vende, nëse nuk gabohem. Prandaj, mendoj se duhet të jepet një informacion më i detajuar për sa i përket këtij projektligji, sepse nuk e shikoj të lidhur me të gjithë historikun që ka ndodhur nga viti 2013 deri tani, në fund të viti 2019 dhe fillim të vitit 2020 që po miratojmë një ligj të ri.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Fino!

Po, zoti Haxhi.

Elton Haxhi- Atëherë, ligji i vitit 2013 ka ratifikuar Konventën për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore dhe kjo konventë parashikon edhe këtë

shkëmbim informacioni, por baza ligjore për shkëmbimin e informacionit është ky projektligj që kemi sjellë sot. Pra, nuk kemi ndryshuar ligjin e vitit 2013, ai është thjesht një angazhim i qeverisë për transparencën dhe bashkëpunimin në çështjet tatimore me vendet anëtare të konventës dhe ky është projektligji, i cili rregullon këtë shkëmbim. Pra, nuk po ndryshojmë...

Bashkim Fino – Pse nuk e keni bërë që atëherë këtë projektligj, në vitin 2016, duke bërë VKM-në, por e sjell tani? Ti thua se është një ligj i ratifikuar, por pse e sjell pas 6 vjetësh?

Elton Haxhi- Ligjin po e sjell sot, sepse shkëmbimi automatik i informacionit, përveç kuadrit ligjor, kërkon edhe një zhvillim aplikacioni IT dhe një platformë, e cila do të ndërlihet edhe me vendet e tjera anëtare. Për këtë projekt ne kemi filluar që në fillim të vitit 2019 me asistencën e ekspertëve të OECD-së, veçanërisht të administratës tatimore italiane, dhe është punuar edhe për kuadrin ligjor, edhe për platformën e shkëmbimit, por nuk po ndryshojmë asgjë nga ligjet apo VKM-të. Ato janë në vazhdimësi dhe ky është hapi tjetër që ndërmerret. Është rënë dakord me OECD-në për këto çështje që unë sapo përmenda, pasi nuk ishin gati as projektligji, as platforma e shkëmbimit, për t'u shtyrë për në vitin 2020. Në vitin 2020 është procedurë normale që ti të shkëmbesh të dhënat për vitin paraardhës, pra nuk po shkojmë me efekte prapavepruese dhe në vitin 2020 shkëmbehen të dhënat e vitit paraardhës që është viti 2019...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, hyn në fuqi në datë X dhe u është lënë 5 muaj kohë bankave që të mbledhin informacionet e vitit paraardhës, pra është një procedurë normale dhe përgatitja e informacionit financiar vjetor, që ndodh çdo vit, ka afat deri në muajin mars. Pra, në muajin mars të vitit 2020 ti bën informacionin për vitin 2019. Ne kemi pasur një komunikim me bankat, të cilat kërkojnë më shumë kohë dhe ne jemi duke diskutuar për një lënie kohë më shumë bankave për ta mbledhur këtë informacion, sepse nuk është e lehtë që një informacion i tillë të mbledhet brenda vitit financiar. Pra, nuk mund të raportosh në vitin 2019 për vitin 2019, por duhet të raportosh në vitin 2020 për vitin 2019. Kjo është një procedurë normale, prandaj është përcaktuar e tillë në këtë projektligj.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Haxhi!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino- Zoti kryetar, zëvendësministri nuk tha asgjë tjetër vetëm tha se në vitin 2013 ishte një angazhim i qeverisë që ne duhet ta merrnim dhe që kemi miratuar një ligj. Kjo do të thotë, ashtu siç e kuptova unë, që pas atij angazhimi të qeverisë duhet të ishte bërë ky projektligj, në mënyrë që të ishte në sinkron me të gjithë punën për të bërë shkëmbimin e

mundshëm automatik të informacionit financiar. Pra, në vitin 2013, këta morën angazhim, si qeveri, nuk e shoqëruan me një projektligj të tillë dhe vijnë e shoqërojnë sot pas 6 vjetëve, duke thënë që do të fillojë në vitin 2018, pastaj më vonë e kështu me radhë.

Pra, ky projektligj që është sot duhet të ecte paralelisht me atë angazhim të qeverisë në vitin 2013, gjë që nuk është bërë. Pyetja ime është konkrete. Pse duhet ta fillojmë këtë shkëmbim informacioni automatikisht në vitin 2020, duke futur në lojë llogaritë e vitit 2019 dhe të mos e bënim në vitin 2013 apo 2014, që kur kemi marrë angazhimin politik dhe e kemi ratifikuar në parlament? Pra, në vitin 2013, parlamenti është treguar i gatshëm dhe i ka thënë që jam dakord të bëni këtë shkëmbim informacioni të llogarive financiare, por këta duhet të ishin më aktivë që ta bënin efektiv në vitin 2014, minimalisht, dhe jo sot në fillim të vitit 2020, pas 6 vjetësh. Fakti që e sjellin sot këtë ligj dhe po e rregullojnë, është në përputhje të plotë me akte ligjore, për të cilat ne po diskutojmë. Prandaj bëra edhe sugjerim, edhe pyetje, sepse kishte një kakofoni në mënyrën e organizimit nga viti 2013 deri tani. Pra, ky informacion i llogarive financiare bëhet efektiv vetëm në vitin 2020, pasi ne ta kalojmë këtë ligj dhe pasi të nxjerrim edhe disa vendime qeverie. Madje, zoti drejtor, me nenin 18 ka një përplasje. Cila është përplasja?! Neni 17 thotë që ky ligj duhet të nxjerrë akte nënligjore për 4-5 muaj, ndërkohë që neni 18 thotë që brenda datës 30 maj, brenda 5 muajve, duhet që të fillojë raportimi për të dhënat e informacionit financiar nga 1 janari i vitit 2019 deri në fund të vitit 2019. Ndaj ndërhyra, i kërkoj ndjesë edhe zëvendësministrit, por po të mos ishte neni 18, që është dispozitë kalimtare, ju që jeni juristë e kuptoni më mirë, do të thotë që ky ligj hyn në fuqi më 1 janar të vitit 2020. Kjo do të thotë që unë nuk kam të drejtë të kërkoj të dhënat e llogarive financiare të vitit 2019. Pse kërkon vetëm ato të vitit 2019? Kërko edhe ato të vitit 2018 me dispozitë kalimtare. Nuk e di çfarë duan të gjejnë dhe kërkojnë me këtë gjë, por për mua duhet rregulluar, në sensin logjik i gjithë projektligji që sjell këtu dhe i gjithë historiku që ka filluar që nga viti 2013 deri në vitin 2020. Unë nuk jam kundër kalimit të projektligjit, ai është i domosdoshëm, madje jemi të vonuar. Vërejtja kryesore që kam unë është që duhet të kishte kaluar shumë kohë më parë.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Haxhi.

Elton Haxhi- Kam një sqarim. Në vitin 2013, konventa që ne kemi ratifikuar nuk ka vetëm këtë si veprim. Pra, ky është një nga veprimet e konventës, por ka edhe angazhime të tjera në kuadër të transparencës dhe të bashkëpunimi tatimor midis vendeve të konventës. Për sqarim, dua t'ju them se për herë të parë ka filluar në vitin 2017. Ne kishim përcaktuar vitin 2018, por vendet e para që kanë shkëmbyer informacion për herë të parë kanë qenë vetëm në

vitin 2017. Pra, edhe vendeve më të zhvilluara u është dashur 3 vjet nga nënshkrimi i konventës deri në shkëmbimin e informacionit. Ne nuk jemi jashtë çdo parashikimi kohor. Në vitin 2017 kanë qenë vetëm 49 vende, në vitin 2018 kanë shkëmbyer informacion 51 vende të tjera, në vitin 2019 vetëm 2 vende kemi të parashikuar për të shkëmbyer në vitin 2020. Këto janë të publikuara dhe të rakorduara me OECD-në dhe me vendet e tjera anëtare të konventës dhe këtu është një bashkëpunim i plotë.

Tani për datën e marrjes së informacionit, që është më 1 janar 2019, nëse ne shkëmbejmë informacion në vitin 2020, detyrimisht do të shkëmbejmë vitin 2019. Nëse do të shkëmbejmë në vitin 2020, i bie që ta bëjmë këtë në vitin 2021, pra nuk mund ta bëjmë shkëmbimin në vitin 2020. Pra, që të kuptohemi, ose e fillojmë tani dhe ne i mbetemi këtij qëndrimi, që fillojmë tani dhe shkëmbejmë vitin 2019 ose përndryshe i bie që të shkëmbejmë vitin tjetër, jo këtë vit.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Haxhi!

Urdhëroni, zonja Xhina!

Elena Xhina - Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim të këtij diskutimi, pra se kur fillon të veprojë ligji, sepse ju thatë se nuk ka fuqi prapavepruese e të tjera, realisht, për ne kjo pjesë ngre shumë pikëpyetje. Ky është një ligj i ri, ngarkon me detyra subjektet e tij, pra ka një subjekt, që janë institucionet financiare raportuese dhe kanë disa detyra që i marrin me këtë ligj. Si mundeni ju që të thoni: “Ne i kemi porositur bankat të marrin informacione që t’i bëjmë për 4-5 muaj”. Me çfarë ligji i keni porositur t’i bëni, kur pikërisht është ky ligj që është ofruesi i shërbimit që mbledh, analizon dhe raporton? Ai nuk ka të drejtë ta bëjë këtë deri më sot, ose derisa të hyjë ligji në fuqi. Si mund ta bëji ai dhe ta keni gati ju për vitin 2019? Pra, më duket pak paradoksale kjo pjesa. Megjithatë, zoti kryetar, për procedurë nuk na pengon që ne ta kalojmë në parim dhe më pas kjo të ngelet pjesë e dispozitës konkrete kur të vijë, por meqenëse u shtrua si diskutim, e ngrita këtë pyetje.

Ulsi Manja - Edhe unë jam dakord që për çështje, të cilat kanë të bëjnë me diskutime për nene konkrete për të ndërhyrë, ne ta bëjmë në pjesën e shqyrtimit dhe miratimit nën për nen. Ndërsa këtu të fokusohemi te pyetjet dhe diskutimet në parim, për ekonomi kohe.

Kush ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi – Në fakt, projektligji ka penalitete, apo jo? Si mund të mendojmë ne që një subjekt, që e detyron në projektligj, të penalizohet për kohën e mosvënies në dijeni?

Pra, ne nuk e kemi vënë në dijeni një subjekt dhe ai mund ta ketë kaluar. Ne tashmë i themi që nga viti 2019 do të japësh llogari, a nuk përbën kjo problem dhe shkelje të të drejtave?

Së dyti, për relatoren, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave, a ka dakordësuar? Do të ishte mirë që ta kishim atë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Urdhëroni, zoti Haxhi!

Elton Haxhi – Ky projektligj ka qenë në diskutim me aktorët kryesorë raportues, që janë bankat e nivelit të dytë dhe ka që në janar të vitit 2019 që ky projektligj është në konsultim me këto subjekte. Pra, ato janë në dijeni. Kanë qenë pjesë e diskutimit të vazhdueshëm dhe, siç ju thashë, kanë kërkuar një shtyrje të afatit të mbledhjes së informacionit, por jo të datës efektive. Pra, jo të janarin të vitit 2019, kanë kërkuar shtyrje të 30 majit, që t’u lihet më shumë kohë për të mbledhur këtë informacion, por besojmë se është kohë e mjaftueshme. Pra, nëse gjykojmë se 30 maji është shumë pak për të mbledhur informacionin, mund të diskutojmë që ta shtyjmë me 1 muaj apo 2 muaj për t’u lënë më shumë kohë për të mbledhur këtë informacion, por një tjetër fakt, që unë dua ta përmend është se bankat e kanë një procedurë që shkëmbejnë informacion, nëse ju mund të jeni në dijeni, shkëmbejnë informacion vetëm për rezidentët amerikanë. Pra, e kanë një procedurë aktuale, ku të gjithë bankat, të cilat nuk duan të bllokohen nga thesari amerikan, kanë nënshkruar një marrëveshjeje, kanë ngritur sisteme, mbledhin të njëjtin informacion, i cili kërkohet edhe nga ky projektligj, dhe e shkëmbejnë vetëm me një autoritet, që janë autoritetet amerikane. Me këtë projektligj ne po kërkojmë që të mbledhim informacion edhe për rezidentët e shteteve të tjera, të cilat janë pjesë e konventës, ku, në mos gaboj, janë 109. Nuk është një procedurë e re për bankat dhe, për më tepër, që kanë 1 vit që janë në konsultim, madje ne kemi diskutuar edhe teknologjinë e shkëmbimit të informacionit. Pra, kemi rënë dakord edhe për teknologjinë që do të përdoret, për gjuhën e transmetimit të informacionit, gjuhën në IT. Kështu që jemi në një fazë goxha të avancuar dhe bankat nuk është se janë të panjohura me këtë projektligj.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Haxhi!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi – Në fakt, zoti Zëvendësministër, unë e di që, po t’u japim pak të drejtë këtyre subjekteve, sepse nuk vijmë më thjesht pa një eksperiencë, por kemi pasur konkat me to. Po ju them një rast timin në një studio ligjore: po u them një transaksion që vinte nga

Greqia, qytetari i kishte kaluar eurot në një bankë tjetër dhe një bankë tjetër i kërkonte një deklaratë noteriale për justifikim. Pra, këto ishin me faturë. Në rastin konkret banka i thoshte: ose 13% të kësaj vlere ma jep mua ose ndryshe nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka lidhje, por unë po them subjekteve në qoftë se do t'u japim oreksin, kështu siç thoni ju, nga 1 janari i vitit 2019 deri më sot, domethënë ato bëjnë kërdrinë.

Ulsi Manja - Ju lutem, ta mbarojë pyetjen kolegu Alimadhi.

Jo shpjegime, por pyetjen konkrete.

Adriatik Alimadhi – I gjithë sensi im ishte që ne me këtë projektligj më shumë ngremë një grackë për qytetarët, pa i informuar qytetarët, pa i bërë të ndërgjegjshëm qytetarët dhe në fund i penalizojmë ata vetëm me gjoba. Kjo ishte e gjitha.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Të lutem, zoti Haxhi, një sekondë, sepse titulli i projektligjit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Projektligji ka si titull “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” dhe që në titull dalin të qartë objekti dhe përmbajtja e projektligjit.

Zoti Përmeti, a keni pyetje? Nuk keni.

Atëherë, pyetje të tjera dhe diskutime nga kolegët nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim,

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen të projektligjit.

Zonja Xhina, të lutem, më ndiq nen për nen dhe aty ku ka propozime konkrete për riformulim, kolegët ta marrin fjalën.

Neni 1 “Objekti i ligjit”.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Ndërhyrjet që janë bërë në dispozita të veçanta, kanë të bëjnë më shumë me faktin që dispozitat të jenë më sintetike, më të qarta, jo se kanë ndryshime thelbësore.

Ulsi Manja - Pra, janë çështje të karakterit të teknikës legislative.

Elena Xhina - Në lidhje me nenin 1 është bërë një riformulim, duke e thjeshtuar dispozitën, duke përcaktuar më qartë objektin dhe duke e shkurtuar pikën “a”, dhe te pika “ç” “Të drejtat dhe detyrimet”, është zëvendësuar me termi “detyrat dhe kompetencat”.

Ulsi Manja – Dakord.

Ministria, a jeni dakord me riformulimin e nenit 1?

Kush është dakord me riformulimin e nenit 1? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka. Miratohet neni 1.

Kalojmë te neni 2 “Qëllimi i projektligjit”.

A ka riformulime?

Urdhëroni!

Elena Xhina – Edhe në nenin 2 ka riformulime për ta bërë më sintetike dispozitën. Edhe këtu është parë e arsyeshme që të bëhet një ndarje e nenit 2, duke e ndarë në dy dispozita, duke shtuar një nen të ri, i cili do të quhet “Parimet e përgjithshme” dhe përmban parimin e përgjithshëm, që ishte në trupën e dispozitës 2.

Ulsi Manja - Pra, shtohet një nen i ri te neni 2?

Elena Xhina – Po, te neni 2 shtohet një nen i ri me titullin “Parimi i përgjithshëm”.

Ulsi Manja - Kush është dakord për shtimin e një neni të ri te neni 2 me titullin “Parimi i përgjithshëm”? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet shtimi i një neni të ri me titullin që tha kolegja Xhina.

U lutem këshilltarëve në numërtimin e neneve të reja në përfundim, pasi ta miratojmë edhe ligjin në tërësi, të reflektohet edhe shtimi i një neni të ri, te neni 2. Pra, neni 2 ndahet në dy nene, një nen me atë titull që tha kolegja Xhina dhe më pas ngelet qëllimi i projektligjit.

Vazhdojmë me nenin 3.

Elena Xhina – Në nenin 3 “Subjektet” përsëri është bërë vetëm një riformulim i vogël, duke hequr një referencë ligjore.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Zonja Xhina, do t’ju lutesha për ekonomi kohe, në rast se riformulime të caktuara janë dakordësuar me ministrinë, ministria duhet të shprehet dakord me riformulimin dhe ne të ecim me nenet.

Neni 4 “Përkufizimet”.

Elena Xhina – Në nenin 4 ka riformulime të teknikës legjislative. Gjithashtu, është bërë një propozim që të shtohet te përkufizimet një pikë e re, pika “gj” për termin “komentari”, pasi nuk gjendet e sqaruar, për të tjerat nuk ka ndryshime.

Ulsi Manja – Dakord ministria?

Elton Haxhi – Dakord.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Nuk ka Abstenim? Nuk ka. Miratohet neni 4.

Kalojmë te kreu II “Detyrimi për raportim”. Ky kre fillon me nenin 5, “Raportimi tek autoriteti kompetent”.

Elena Xhina – Përsëri kemi vetëm një riformulim të teknikës legislative, ku është hequr një referencë ligjore.

Ulsi Manja – Dakord ministria me nenin 5?

Elton Haxhi – Dakord.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 5, me sugjerimin e relatores? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Neni 6 “Vigjilenca e duhur”.

Elena Xhina – Në nenin 6 “Vigjilenca e duhur” është hequr një togfjalësh për qëllim të nenit 5. Sugjerohet që referenca të bëhet me akte nënligjore. Pra, janë hequr disa formulime të gjata për t’i bërë më sintetike dispozitat, të cilat janë dakordësuar me ministrinë.

Ulsi Manja – Dakord ministria me nenin 6?

Elton Haxhi – Dakord.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 6? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 6.

Kalojmë te neni 7 “Ndarja e informacionit brenda të njëjtit grup ose me ofruesit e shërbimit pala e tretë”.

Elena Xhina – Edhe në nenin 7 është sugjeruar bashkimi i dy paragrafëve të parë në një të vetëm dhe ndarja e tij në dy nënparagrafë.

Gjithashtu, është hequr termi “detyrim”, që është një referencë e pikës 4 të nenit 5 dhe zëvendësuar me fjalët “aktet nënligjore në zbatim të tij”.

Ulsi Manja – Ministria, a jeni dakord me nenin 7?

Elton Haxhi – Ne do të preferonin variantin tonë.

Elena Xhina - Ndryshimi midis dy varianteve qëndron te fakti se ministria i ka stërholluar dhe i ka shpjeguar më shumë seç duhet, ne i kemi bërë më sintetike.

Ulsi Manja – E prek përmbajtjen e projektligjit?

Elena Xhina – Jo, nuk e prek përmbajtjen e projektligjit.

Ulsi Manja – Si qëndron më mirë riformulimi në nenin 7, në variantin siç është formuluar del më i qartë kuptimi, apo siç e propozon kolegja? Kam hallin e zbatimit në praktikë, si do të jetë më e qartë nesër, kur të zbatohet ligji?

Elton Haxhi – Ne te varianti ynë e kemi më të detajuar.

Ulsi Manja – Zonja Xhina, të lutem, sepse ti ke bërë propozimin për riformulim. Kjo më duket çështje e teknike legjislative.

Elena Xhina – Ashtu është, por po të jetë në kuptimin e një akti ligjor, konform procedurave, mendoj se do të ishte më koncize dispozita. Megjithatë, nuk ka problem.

Ulsi Manja – Pa dashur të ndërhyj, ky projektligj është nga konventa që ne kemi ratifikuar në vitin 2013. Në përgjithësi, konventat këto riformulime kanë. Nëse është, në standard me legjislacionin e BE-së...

Elena Xhina - Nëse përfaqësuesit mendojnë se ia vlen të qëndrojnë riformulimi i tyre, në rregull, nuk na prish punë.

Ulsi Manja – Gjithsesi, deri në momentin, kur ta bëjmë raportin për komisionin përgjegjës, zonja Xhina me përfaqësuesit e ministrive të shikojnë se si qëndron më mirë riformulimi.

Kush është dakord me nenin 7? Kundër?1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Neni 8 “Detyrat dhe kompetencat e autoritetit kompetent”.

Elena Xhina – Edhe në nenin 8 është sugjeruar riformulimi i fjalisë së parë të paragrafit të parë. Është bërë një formulim i paragrafit të dytë dhe është hequr një term, sipas komunikimit formal ndërmjet palëve. Është edhe një riformulim i paragrafit 4, që përsëri ka të bëjë me teknikën legjislative, pa e prekur në thelb vetë dispozitën.

Ulsi Manja – Dakord ministria me nenin 8?

Elton Haxhi – Dakord

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Nuk e di riformulimin që tha relatorja, mund të jetë kjo vërejtja që kam unë dhe unë tërhiqem, por nuk e kam parasysh.

Elena Xhina - E keni në fund.

Bashkim Fino – Ajo që dua të them: ju pak më parë i dhatë të drejtë Ministrisë së Financave dhe thatë se ratifikimi i marrëveshjes kuadër duhet bërë kështu, por ne po bëjmë një ligj, zoti kryetar, nuk është udhëzim. Këta duhet të kuptojnë se ligji jep terma të përgjithshëm, nuk mund të bëhet udhëzim. Më lejoni t’ju thyes se në nenin 8 nuk mund të shënohet këtua: “Autoriteti kompetent nëpërmjet strukturave të tij të varësisë mund të kërkojë informacion nga çdo institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë në çdo kohë të arsyeshme, gjatë orarit zyrtar të punës së një institucioni të tillë financiar”. Këto janë çështjet e teknikës së udhëzimit, që duhen hequr. Për mua neni 8, pika 1, duhet të ishte shumë i thjeshtë. “Autoriteti

kompetent ndërmjet strukturave të tij të varësisë mund të kërkojë informacion në çdo institucion financiar raportues në Republikën e Shqipërisë në çdo kohë”. Kjo është më e sakta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk e kam këtu dhe kam bërë vërejtjet e mia dhe kam të drejtë të flas. **Ulsi Manja**
– Mund të vazhdoni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Edhe për ty është më mirë kështu, sepse nuk mund t’i thuash atij që bëjeni jashtë orarit zyrtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Në nenin 2 afati 15-ditor mua më duket pak i tepërt dhe më pas është i lidhur me pikën 3, ku thuhet se ky afat mund të shtyhet sipas komunikimit formal nëpërmjet palëve, kërkesës së institucionit e të tjera. Pra, është kthyer thjesht në një udhëzim. Niko, unë jam për një afat konkret dhe më të shkurtër, brenda një jave, dhe ai e ka për detyrë ta japë, sepse ai të dhënat e llogarive të mia i ka dhe fare mirë çdo bankë thotë: ‘Po, kjo është gjendja e llogarisë 1, 2 3, 4 apo 5’. Po të shkruash në ligj edhe një nen tjetër që, në qoftë se unë nuk i jap dot llogaritë e zotit Fino, por duhet që për këto llogari të hyjnë në një marrëveshje tatimet me bankën e nivelit të dytë, pas 15 ditëve të bëjnë një marrëveshjeje, pra më duhet më shumë se 15 ditë, meqenëse është shkelur ligji, mua më duket absurde. Për këtë duhet një afat brenda një jave dhe këtu nuk ka pse të vendosim një nen tjetër, pra po hyjnë në marrëveshje të dyja institucionet dhe po kaloi ky afati 15-ditor, mund ta shtyjme këtë gjë. Cila është logjika? Ata e kanë për detyrë ta zbatojnë ligjin, si tatimet, ashtu edhe banka, pra të japin informacion. E kam ndihmë për ju këtë, sepse me pikën 3, që ju keni vënë, i jepni mundësi të dyja institucioneve të krijojnë herë pas here ndonjë material që të thonë: prit se do ta shtyjme edhe 10 ditë, do ta shtyjme edhe 7 ditë dhe nuk i gjendet kurrë fundi se kur e merr informacionin institucioni juaj i tatimeve. Ti duhet të jesh i interesuar ta rregullosh këtë pikën 3. Nuk mund të vihet kështu kjo.

Ulsi Manja – Është diskrecion. Me komunikim formal ndërmjet palëve edhe mund të shtyhet afati.

Faleminderit, zoti Fino!

Urdhëroni, zonja Xhina, në lidhje me nenin 8!

Elena Xhina – Në lidhje me nenin 8, unë i vlerësoj shumë sugjerimet e kolegut Fino, pasi janë të natyrës financiare dhe ekonomike, për të cilat unë nuk jam eksperte dhe mund të flas vetëm në termin ligjor. Kështu që sugjeroj të gjitha këto sugjerime t’i çohen komisionit përgjegjës, duke vlerësuar që të merren në konsideratë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Atëherë, riformulimi të karakterit financiar, duke pasqyruar brenda edhe shqetësimin e ngritur nga kolegu Fino, të cilat të jenë pjesë e raportit për komisionin përgjegjës, më lejoni ta hedh në votim nenin 8.

Kush është dakord me nenin 8, bashkë me sugjerimet? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 8.

Neni 9 “Mbajtja e të dhënave dhe detyrimi për ruajtjen e tyre”.

Elena Xhina – Edhe në nenin 9 ka vetëm një ndryshim të karakterit të teknikës legjislative në pikën “a”, të tjerat nuk janë prekur.

Ministria, a jeni dakord me nenin9?

Elton Haxhi – Dakord.

Ulsi Manja – E hedhim në votim nenin 9.

Kush është dakord me nenin 9? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Kalojmë te neni 10 “Shkëmbimi i informacionit mbi llogaritë e raportueshme”.

Elena Xhina – Në nenin 10 përsëri bëhet sugjerimi që të hiqen terminologjitë në lidhje me konventën, pasi nuk ka nevojë të përmendim dispozitat e konventës në përputhje me to, pasi do ta bënin shumë të gjatë dispozitën dhe është sugjeruar që termi “juridiksion” të zëvendësohet me termin “autoritet”, sepse nuk kemi të bëjmë me juridiksionin.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Ky është një sugjerim teknik dhe këtyre u ka shpëtuar. Po ta lexosh paragrafin, thotë: “Brenda 9-mujorit të parë”. Tani, ne vitin e kemi 12 muaj nuk e kemi 18 muaj. Kjo duhet thënë: “brenda 9-mujorit”, duhet hequr fjala “të parë”, sepse na i shtojnë edhe në ligj padrejtësisht vitin. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ku ka 9-mujorin e parë? 6-mujorin e parë, po.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 10 dhe me sugjerimin e kolegut Fino?

Elton Haxhi – Te riformulimi që ka bërë komisioni propozojmë që të mbetet “autoritetet kompetente të juridiksioneve të tjera”. Ju e keni bërë propozimin “autoritete”, por duhet saktësuar se cilat janë këto autoritete. Janë “autoritetet kompetente”, sepse është te termat e ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, në rregull e keni: “Autoriteti kompetent shkëmben me të juridiksione të tjera kompetente”, po “juridiksione kompetente” e keni përdorur “autoriteti kompetent shkëmben me juridiksione të tjera”. Po pse duhet të jetë edhe pas fjalës “juridiksion kompetent” përsëri?! E keni në fillim të fjalisë “autoriteti kompetent shkëmben me juridiksione të tjera”.

Elton Haxhi – Riformulimi që ka bërë zonja, e ka hequr këtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – “Juridiksioneve të tjera kompetente”, çfarë janë këto?!

Elton Haxhi - Autoritetet kompetente janë drejtoritë tatimore të juridiksioneve të tjera, pra të shteteve të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, të mos mbetemi te neni 10. Ato sugjerime, që janë të teknikës legislative, t’i reflektoni në raport. Ju lutem, zonja Xhina, nuk e rregullojmë dot ligjin tani këtu me pika dhe me presje. Ne biem dakord në parim që sugjerimi që bën relatorja të gjejë vend në tekstin e projektligjit në nenin 10, të kalojë dhe të jetë pjesë e raportit.

Kush është dakord me nenin 10? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 10.

Kalojmë te kreu III “Sanksionet dhe anikimimi administrativ”. Ky kre fillon me nenin 11 “Kundërvajtjet administrative”.

Elena Xhina – Në nenin 11 është sugjeruar që termi “shkelje” të zëvendësohet me “veprimet” apo “mosveprimet”, duke qenë para faktit se jemi në kuadrin e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë kundërvajtje administrative. Nga ana tjetër, në germën “ç” janë bërë disa saktësime në formulim, pasi është përsëritur dy herë kryerja e detyrave brenda së njëjtës pikë. Gjithashtu, germa “d” është parë e arsyeshme të ndahet në dy nënpika, pasi nuk mund t’i përfshijmë në të njëjtën dispozitë neglizhencën dhe veprimet e qëllimshme, kur dihet se janë dy gjëra krejt të ndryshme. Te neglizhenca nuk mund të flasim për dashje, ndërkohë që veprimet e qëllimshme përfshijnë edhe dashjen.

Kam menduar të ndahen dispozitat, duke diferencuar kështu edhe masën e dënimit.

Ulsi Manja – Më falni t’ju ndërpres! Kur thoni: ndahen dispozitat, flisni për një nen të ri?

Elena Xhina – Jo, shtohet një pikë e re.

Ulsi Manja – Pra, në pikën 1 thuhet: “Shkeljet e kryera zëvendësohen me fjalët “veprime ose mosveprime” dhe të shtohen dy...

Elena Xhina – Jo, shtohet një germë “e”, pra germa “d” ndahet në dy nënpika.

Ulsi Manja – Ju thoni që germa “d” të ndahet në dy nënpika, domethënë të ketë edhe një pikë “e”?

Elena Xhina – Po, pasi kështu ndajmë veç dashjen, veç neglizhencën.

Ulsi Manja – Biem dakord?

Bashkim Fino – Unë kam një pyetje.

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Për nenin 11, germa “c”, më lejoni ose më jepni një argument për germën “c”. Ju thoni: “Kryerja e deklarimit të rremë, ose një vepër tjetër, mosdhënia e informacionit të kërkuar nga çdo mbajtës llogarie”... Pra, nuk është e njëjta gjë edhe moskryerja e deklarimit të rremë, domethënë, unë nuk e kryej deklarimin e rremë, ndërkohë tjetra është mosdhënia e informacionit. Shtroj pyetjen: të dyja këto i bashkoni me këtë lloj gjobe? Sepse nuk kanë të njëjtin nocion të dyja ato. Është tjetër gjë kur nuk e jap informacionin, është tjetër gjë kryerja e deklarimit të rremë. Pra, e bëj të rremë informacionin, për shembull, ty si tatime ta jap të rremë informacionin (dhe kjo është e qëllimshme ose jo, unë nuk e di) ose unë nuk ta jap informacionin.

Janë dy nocione tërësisht të kundërta.

Kur kryerja e deklarimit është e rremë, është më e rëndë për mua. Natyrisht, edhe mosdhënia e informacionit në zbatim të ligjit është e rëndë, nuk diskutohet. Gjithsesi, në qoftë se ju të dyja këto, edhe relatorja, i bashkoni te një gjobë prej 1 milion, unë jam dakord. Por sugjeroj që kryerja e deklarimit të rremë është një vepër më e rëndë, si të thuash, një kundërvajtje administrative më e rëndë, sepse të lejon ty, si tatime, ose edhe nga informacioni që ka marrë që të jep një informacion të rremë. Unë nuk e di ku shkon pastaj ti me atë informacion të rremë, se si e kryen aktivitetin e subjektit përkatës e të tjera me radhë, madje mund të marrë edhe rrjedhë tjetër gjykimi, ndryshimi e të tjera. Ndërkohë, sa të dalë informacioni i vërtetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj, unë mendoj se kryerja e deklarimit të rremë është shumë e rëndë, pasi e bën me vetëdije punonjësi i bankës ose ai atje jashtë për llogaritë e mia. Kjo kërkon, ndoshta, një gjobë më të madhe.

Ulsi Manja – Deklarimi i rremë shkon në suazën e një vepre penale.

Bashkim Fino – Nuk mund t’i bashkosh të dyja me këtë gjë. Gjithsesi, këtë e gjykoni ju, pasi jeni ekspertë, por mendoj se nuk janë të njëjtat gjëra. Mosdhënia e informacionit është diçka që nuk e dha, do ta detyrojë ligji me forcë dhe do ta japë, nuk ka çfarë bën, por dhënia e gabuar është më e rëndë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Atëherë, në vijim të asaj që sugjeron kolegu Fino, unë sugjeroj që germa “c” e pikës 1 të ndahet. Të bëjmë një përshkallëzim të kryerjes së deklarimit të rremë te sanksioni dhe një sanksion tjetër për mosdhënien e informacionit të kërkuar. Pse? Sepse, kur thuhet “mosdhënie e informacionit të kërkuar nga çdo mbajtës llogarie” presupozohet që është

ky informacion dhe është i saktë, por nuk e jep. Ndërsa kryerja e deklarimit të rremë, unë sugjeroj të ndahet në dy...

Zonja Xhina!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elena Xhina – Shprehem dakord.

Ulsi Manja – Bashkë me ministrinë, përpara se të bëjmë raportin për komisionin përgjegjës, të ndahet germa “c” e pikës 1 dhe sanksionet përkatëse të jenë të përshkallëzuara për të dyja: ndryshe për kryerjen e deklarimit të rremë, që të jetë pak më e ashpër, dhe sanksion tjetër për mosdhënien e informacionit të kërkuar, siç sugjeron edhe kolegu Fino.

Biem dakord me nenin 10 me sugjerimet e bëra? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 10, me ndryshimet përkatëse.

Kalojmë te neni 12 “Ankimi”.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Te neni 12 është bërë vetëm sugjerimi, që të mos përcaktohet në nen numri i ligjit “Për procedurat tatimore”, që është një rregull i teknikës legislative.

Ulsi Manja – Dakord.

Edhe ministria është pro nenit 12? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 13 “Rregulli kundër shmangies”.

Elena Xhina – Për nenin 13 ka vetëm rregullime të teknikës legislative, pa e prekur thelbin e dispozitës.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 13? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe neni 13.

Kalojmë te kreu IV i këtij projektligji “Konfidencialiteti dhe sigurimi i të dhënave”, i cili fillon me nenin 14 “Konfidencialiteti”.

Elena Xhina – Në nenin 14 përsëri në pikën 1 është bërë një ndryshim për të mos përmendur emrin e ligjit në dispozitë, ndërsa në pikën 4 është bërë një shkurtim i dispozitës, për të mos përmendur të gjithë konventën. Nuk ka ndryshim tjetër.

Ulsi Manja – Biem dakord, ministria?

(Përfaqësuesit e ministrisë shprehen dakord.)

Bashkim Fino – Më falni, kam edhe një pyetje!

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Në parim, se ne e bëjmë shumë mirë ligjin, neni 14 do të zbatohet? E kam shumë të drejtpërdrejtë. Ndoshta këta nuk japin dot përgjigje, sepse do të ketë të tjerë që

do të punojnë për këtë gjë, por kur themi: “konfidencialiteti”, do të thotë që ligji të zbatohet. Po në qoftë se nuk e zbaton, çfarë bëhet? Që i nxjerr të dhënat e një subjekti të caktuar padrejtësisht, bën sikur e ruan të fshehtë, por përsëri në një mënyrë a një tjetër përdor mediet apo këto të tjerat për ta nxjerrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra.

Ulsi Manja – Kush e zbaton?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse do të thuash: “Informacioni i siguruar nga institucionet financiare raportuese në Republikën e Shqipërisë është konfidencial”, këtu mbyllet problemi. Kush është pro?

Elena Xhina – Pra, sugjeroni për ta hequr.

Ulsi Manja – Po.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 14.

Kalojmë te neni 15 “Siguria e të dhënave”.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Nuk ka ndryshime.

Ulsi Manja – Kush është dakord?

Elton Haxhi – Një sekondë. Pikërisht te ligji “Për procedurat tatimore” i kemi të përcaktuara rregullat e konfidencialitetit.

Nikolla Lera – Se edhe këto të dhëna taksapaguesish janë dhe atje është trajtuar si çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Dakord.

Elton Haxhi – Për analogji, është e njëjta gjë me informacionin që mblidhet për procedurat tatimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – “Si dhe çdo ligj tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë”, thotë pika 4 e këtij neni.

Kalojmë te neni 15 “Siguria e të dhënave”, për të cilin nuk ka ndryshime. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu V “Dispozita përfundimtare”, i cili fillon me nenin 16 “Interpretimi”.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Në nenin 16 shprehja “Vendime të Këshillit të Ministrave të dala në zbatim të tij” është zëvendësuar me shprehjen “dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij”.

Ulsi Manja – Biem dakord?

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Përfaqësuesit e ministrisë shprehen dakord.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 17 “Aktet nënligjore”.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Lidhur me aktet nënligjore, unë sugjeroj të përcaktohen shprehimisht se cilat janë dispozitat që kanë nevojë për akte nënligjore. Mendoj se këtë duhet ta bëjë patjetër Ministria e Financave për ta kaluar pastaj te komisioni përgjegjës për t’i përcaktuar dispozitat konkrete që kanë nevojë për akte ligjore me afatet e duhura dhe cilat janë autoritetet që do t’i nxjerrin këto akte ligjore.

Ulsi Manja – Dakord me sugjerimin që për aktet nënligjore, që do të duhet të nxirren, duke qenë se janë çështje ekonomike, pra çështje teknike, ne do të mjaftohemi me sugjerimin për komisionin përgjegjës që të detajohen në nenin 17 se cilat janë aktet nënligjore që duhet të nxirren në zbatim të këtij ligji.

Bashkim Fino – Më falni! Pika 4 e ka të përgjithshme.

Ulsi Manja – Po pra.

Bashkim Fino – Sepse çfarë bëjmë ne te neni 17?! Ne themi që ngarkojmë Këshillin e Ministrave që, në funksion të nenit 5, pika 4, të nxjerrë aktet nënligjore. Neni 5, pika 4 e tij thonë: “Dispozitat zbatuese të ligjit miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për financat”. Por cilat janë ato?

E dyta, edhe në kuadrin e pyetjes dhe të diskutimit që bëra unë, në qoftë se kjo çështje është e ezauruar që në vitin 2013 dhe këta janë të përgatitur, pse duhet të lihet tri muaj kohë për të nxjerrë aktet nënligjore? Ato mund të dalin edhe më shpejt, për të qenë edhe korrektë me nenin 18 që do të vijë më poshtë. Se u lini muaj të tërë akteve nënligjore dhe pastaj nuk e kuptoj.

Ulsi Manja – Unë mendoj se periudha tremujore është e mjaftueshme për të nxjerrë aktet nënligjore, por unë jam dakord me shqetësimin që ngrenë kolegët: në nenin 17 të detajohet se cilat janë aktet nënligjore që do të nxjerrë Këshilli i Ministrave, në zbatim të pikës 4 të nenit 5. Nuk mund të lihet kështu, madje kjo të përfshihet në raport.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi – Dakord.

Ulsi Manja – Kush është pro nenit 17, me sugjerimin përkatës?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 18 “Dispozita kalimtare”.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Neni 18, zoti kryetar, lidhet me diskutimin që bëmë në parim dhe unë këtu kam një reformulim: “Institucioni financiar raportues”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, ju lutem, më ndiqni pak te reformulimi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Riformulimi të jetë: “Institucioni financiar raportues, pas aplikimit të procedurave të vigjilencës së duhur, raporton pranë administratës tatimore brenda datës 30 maj për llogaritë e raportueshme të vitit kalendarik pasardhës”.

Ulsi Manja – Po, zoti Përmeti.

Andi Përmeti – Jam dakord me zonjën Xhina, sepse kjo dispozitë ishte edhe arsyeja pse unë votova parimisht kundër. Kjo është dispozita që rrëzon tërë ligjin. Ti nuk mund të bësh një ligj me fuqi prapavepruese. Nuk ka asnjë kuptim dhe ne nuk duhet ta lejojmë në këtë komision.

Unë nuk e kuptova as zëvendësministrin e Financave, i cili deklaroi se janë urdhëruar bankat pa pasur një ligj. Po sikur ky ligj të mos kalojë në parlament?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi – Jo, unë nuk thashë...

Andi Përmeti – Një minutë, ju lutem, të mbaroj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se dëgjova çdo argument që dhatë! Kështu që kjo dispozitë kalimtare, që ligjit i jep fuqi prapavepruese, është totalisht...

Ulsi Manja – Nuk është me fuqi prapavepruese, more! A e lexoni nenin, apo jo?

Andi Përmeti – Si nuk qenka me fuqi prapavepruese?!

Ulsi Manja – Çfarë thoni tani?! Lexojeni ligjin, sepse thotë që në vitin 2020 do të raportohet për një vit paraardhës, për vitin 2019.

Andi Përmeti – Po pra, ligji nuk ka hyrë në fuqi.

Ulsi Manja – E ku është fuqia prapavepruese? Është ratifikuar konventa në vitin 2013, madje ka shkëmbim automatik të dhënash edhe sot.

Andi Përmeti – Zoti Manja!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zonja Xhina, edhe tani shkëmbehen të dhënat!

Andi Përmeti – Zoti Manja, këtu ka plot ekonomistë që mund ta deklaronin këtë, por juve nuk ju shkon...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Dakord, mbarojeni mendimin!

Andi Përmeti – Ligji pa hyrë në fuqi, ju thoni që nuk është me fuqi prapavepruese.

Ulsi Manja – E zgjidhim, e hedhim në votë atë punë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Përmeti, mbaruat?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Kjo konventë është bërë që në vitin 2013, madje unë kritikova dhe thashë në fillim që duhet të hynte në fuqi shumë më shpejt. Tani hyn në fuqi në janar të vitit 2020. Absolutisht, nga shpjegimet që bëjnë edhe specialistët këtu, kjo është formuluar saktë tani, sepse, kur thuhet që vetëm në rastin e parë, si të thuash, për informacionin e parë duhet data 30 maj e vitit 2020 për të gjitha llogaritë raportuese ekzistuese nga 1 janari i vitit 2019, presupozohet që janë të gjitha llogaritë edhe në vitin 2018, edhe në vitin 2017 e me radhë. Pra, çdo llogari që ke ti apo unë, zoti kryetar (po marr shembull ju dhe veten, pa na keqkuptuar këta të tjerët), në qoftë se do të jepet informacion, në vitin 2019 janë të mbartura viti 2017, viti 2018 e kështu me radhë. Kjo do të thotë që e nis nga viti 2019 dhe i ke të gjitha, duke filluar që nga konventa, e cila është ratifikuar në vitin 2013. Unë mendoj se është korrekte.

Ulsi Manja – Pra, bëhet fjalë për raportimin e parë.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Atëherë, unë bëra një riformulim. Ai riformulim do të thotë që në datën 30 maj të vitit pasardhës bëhet raportimi. Atëherë, nëse e bëmë ose jo ne, këtë përjashtimisht e kanë bërë zotërinjtë këtu, në datën 30 maj do të raportojë për vitin 2019. Pse duhet ta vendosim në ligj?

Ulsi Manja – Ku e dimë ne si do të raportohet për vitin 2019?

Elena Xhina – Si mund të vendosësh në ligj një periudhë përjashtimore? Ju lutem, tani! A e thua “për vitin pasardhës”?

Ulsi Manja – Dakord, e lëmë kështu siç është në komision.

Elena Xhina – E vëmë ose jo ne, ajo është detyrimisht për vitin pasardhës.

Ulsi Manja – Ju lutem!

Ne si Komision Ligjesh shprehemi vetëm për një gjë. Diskutimi është nëse ligji ka ose jo fuqi prapavepruese. Por në këtë nen nuk është ky thelbi i diskutimit, sepse këtu po thuhet: “përrjashtimisht për raportimin e parë”...

Elena Xhina – Përse duhet ta themi...

Ulsi Manja – ...sepse ligji do të hyjë në fuqi më 1 janar të vitit 2020, do të raportohet vetëm periudha paraardhëse që është 2019-ta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse komisioni përgjegjës e sheh të arsyeshme në terma financiarë ta detajojë nenin 18, le ta bëjë. Unë jam që ta hedhim në votim nenin 18 me riformulimin që të hiqet pjesa e parë përrjashtimisht për raportimin e parë, por datat jo.

Elena Xhina – Këtë jemi duke thënë.

Ulsi Manja – Unë nuk jam që datat të preken.

Elena Xhina – Nuk po prekim data.

Ulsi Manja – Jo, datat i prek, sepse ti thua...

Elena Xhina – Tani, të lutem, zoti kryetar! Nëse unë them...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ç’rëndësi ka e hedhim në votim, Elena, të lutem?!

Elena Xhina – Të përfundoj arsyetimin. E bëtë ju tuajin, ta bëj edhe unë timin. Kur ne themi: “Raporton pranë administratës tatimore brenda datës 30 maj për llogari të raportuesve të vitit kalendarik paraardhës”, nëse ky hyn më 30 maj të vitit 2020, automatikisht a nuk do të raportohet 2019-ta?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Çfarë problemi prish sikur të rrijë...

Elena Xhina – Si mund të vësh një ligj që qëndron për një vit?

Ulsi Manja – A të bëj një pyetje: çfarë problemi ka nëse vitet qëndrojnë kështu?

Elena Xhina – Sepse në një ligj nuk mund të vendosim për një vit të caktuar një gjë kot që nuk ka asnjë lidhje...

Ulsi Manja – Dakord, ky është mendimi yt.

Elena Xhina – ...dhe që në vitin 2025 nuk do të jetë fare aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Nen transitor është.

Elena Xhina – Por edhe pa qenë kjo, 2019 raportohet pra. Nuk e kuptoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Fino, dispozita transitore do të bjerë pas një viti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elena Xhina – Pikërisht që të mos bjerë, unë them të mos jetë, ju bëni si të doni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Kush është dakord me nenin 18 që t’ia lëmë komisionit përgjegjës të bëjë riformulimin e duhur? Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kemi bërë riformulimin ne.

Biem dakord me nenin 18, siç është varianti këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, dakord, ta hedhim në votim.

Zoti Fino!

Kush është dakord me nenin 18, sipas variantit që është sjellë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Relatorja thotë të mos jetë në ligj, pra sugjeron të hiqet viti, por në parim është dakord me nenin 18.

Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 19 “Hyrja në fuqi” e ligjit. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te votimi në tërësi i projektligjit.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tri vota kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka rëndësi. Ju lutem, se është i lirë votimi në komision!

Abstenim?

Ju lutem, zoti Përmeti, se jam në votim!

Kush është dakord? Ju lutem, të numëroj votat!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Tri vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”.

Do t’u lutesha relatores, këshilltarëve dhe përfaqësuesve të ministrisë që në hartimin e raportit për komisionin përgjegjës të gjejnë reflektim të gjitha sugjerimet që ka bërë Komisioni i Ligjeve; edhe ato saktësimet që u dakordësuan të bëhen të përfshihen në tekstin e projektligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elena Xhina – Gjithashtu, duhet të kihet kujdes që në raportin që do t’i paraqesim komisionit përgjegjës, pasi ne kemi bërë një ndryshim në dispozita, të kemi parasysh edhe disa referenca ligjore që mund të jenë bërë në nene të ndryshme që t’u përshtaten numrave të rinj që do të vendosen në dispozicion.

Ulsi Manja – Zonja Xhina, jeni relatore e projektligjit dhe, përpara se të vijë raporti për t’iu drejtuar komisionit përgjegjës, keni përgjegjësinë të shihni në raport reflektimin e të gjitha çështjeve që u dakordësuan në Komisionin e Ligjeve.

Komisioni i Ligjeve u shpreh që në fillim dakord se projektligji është në përputhje me Kushtetutën, derivon nga ratifikimi i një konvente të miratuar me ligjin nr. 146, datë 06.05.2013 (që e ka ratifikuar Shqipëria), Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u shpreh dakord me projektligjin që nuk ka probleme kushtetuese dhe ligjore dhe është në standardet që kërkon BE-ja.

Faleminderit kolegëve për votën!

Shumë faleminderit zotit Haxhi dhe stafit të Ministrisë së Financave!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.12.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “Fulbright”. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Damian Gjiknuri, Bashkim Fino, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Përmeti, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti, Alban Zeneli, Ediola Braha, Nikolin Staka dhe Artemisa Malo

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Konstandin Shkurti – Zëvendësministër i Arsimit, Sporteve dhe Rinisë

Erzen Tola – Drejtor i Përgjithshëm Rregullator i Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës: shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “*Fulbright*”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

(Diskutime në sallë)

Ju lutem, kolegë, pak qetësi!

Relator i këtij projektligji do të jetë kolegu Andi Përmeti.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë: zoti Konstandin Shkurti, zëvendësministër, dhe zoti Erzen Tola, drejtor i Përgjithshëm Rregullator i Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë.

Zoti Shkurti, mirë se keni ardhur në komision!

Do t’ju lutesha të bënit shumë shkurtime për kolegët e mi të komisionit një prezantim të këtij projektligji, për t’ia kaluar më pas fjalën kolegut Përmeti, si relator i tij.

Fjala është për ju.

Konstandin Shkurti – I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar deputetë,

Jemi këtu për prezantimin e projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “*Fulbright*”.

Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, sipas iniciativës së ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, ka hartuar projektvendimin e mësipërm, i cili është i miratuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave të datës 23.09.2019.

Duke qenë se ky memorandum sjell një detyrim financiar, kërkon nevojën të ratifikohet në Kuvend sipas nenit 121 të Kushtetutës. Ligji ka dy nene, ratifikimin e memorandumit dhe hyrjen në fuqi të tij.

Qëllimi i projektligjit

Projektligji është hartuar në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Me anën e këtij memorandum palët bien dakord për zbatimin e programit të shkëmbimit akademik “*Fulbright*” në arsim, kulturë, shkencë dhe kërkim, me qëllim realizimin e përfitimeve akademike të ndërsjella ndërmjet palëve.

Ky memorandum mirëkuptimi vjen si iniciativë e ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila ka filluar në fund të viteve 2000 dhe është rishikuar në vitet 2016-2017.

Programi “*Fulbright*” u themelua në vitin 1945 dhe mbështet shkëmbimet arsimore që forcojnë mirëkuptimin dhe komunikimin ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe mbi 155 vendeve në mbarë botën; është në formën efektive dhe prestigjioze të diplomacisë publike. Gjatë kësaj historie ky program ka pasur 286 pjesëmarrës, 47 mijë studentë të Shteteve të Bashkuara dhe 150 mijë studentë nga vende të tjera të botës.

Përmbajtja e memorandumit

Me anën e këtij memorandumimi mirëkuptimi synohet që çdo vit të përzgjidhen studentë, personel akademik dhe profesionistë nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucione të tjera të Republikës së Shqipërisë për të studiuar në universitetet e Shteteve të Bashkuara, si dhe të koordinohet dërgimi i studentëve, i personelit akademik dhe i profesionistëve në Shtetet e Bashkuara nga institucione akademike apo institucione të tjera të Republikës së Shqipërisë për studime, kërkime ose stazhe akademike.

Pala shqiptare do të ketë përfaqësues në komisionin përzgjedhës pranë ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë për të përzgjedhur studentë, personel akademik dhe profesionistë që do të marrin pjesë në programin “*Fulbright*”.

Pala shqiptare do të ofrojë mbështetje financiare në shumën 150 mijë euro nëpërmjet fondit të bursave të ekselencës për të mbështetur kostot e programit “*Fulbright*”. Kontributi do të paguhet duke filluar nga viti akademik 2019-2020 deri në vitin akademik 2024-2025, ndërsa pranimi do të fillojë nga viti akademik 2020-2021 e në vijim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem vazhdoni, zoti Shkurti!

Konstandin Shkurti – Gjatë zbatimit të këtij memorandumimi, palët pjesëmarrëse planifikojnë të shkëmbejnë informacion rreth pjesëmarrjes së institucioneve arsimore për dhënien përparësi nevojave arsimore, kulturore dhe shkencore të këtyre institucioneve.

Gjatë zbatimit të këtij memorandumimi pala shqiptare synon të nxisë institucionet qeveritare që të mundësojnë kushte më të favorshme të mundshme për zbatimin e programit “*Fulbright*” në Republikën e Shqipërisë. Pala shqiptare synon të koordinojë aprovimin në kohën e duhur dhe lëshimin e dokumenteve ligjore të nevojshme për studentët, personelin akademik dhe profesionistët për pjesëmarrjen në programin “*Fulbright*” në Republikën e Shqipërisë. Palët do të shkëmbejnë informacion duke u dhënë përparësi nevojave të tyre në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Memorandumimi përmban, ashtu siç thamë, në pikën 2 hyrjen në fuqi të tij, i cili fillon pas njoftimit të pjesëmarrjes nga autoritetet kompetente për përfundimin e të gjitha

procedurave të nevojshme të brendshme dhe do të vijojë për një periudhë 5-vjeçare. Kjo ishte pjesa përmbledhëse e relacionit tonë. Ju ftojme që ta votoni këtë projektligj.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shkurti!

Zoti Përmeti, si relator i këtij projektligji, keni fjalën.

Andi Përmeti – Së pari, dua të falënderoj zotin Shkurti për prezantimin!

Me aq sa dëgjova, ishte një prezantim i plotë, kështu që detyrohem që t'i bie shkurt vetëm për pikat ligjore.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe e shqyrton këtë projektligj në zbatim të neneve 32 deri në nenin 38 të Rregullores së Kuvendit. Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Ratifikimi i këtij memorandum mirëkuptimi bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, kreu II “Marrëveshjet ndërkombëtare”, neni 121 i saj. Ky memorandum mirëkuptimi ka qëllim nxitjen e mirëkuptimit dhe të miqësisë së ndërsjellë ndërmjet programit të shkëmbit akademik “*Fulbright*” në institucionet arsimore shkencore dhe kërkimore në të dyja vendet nënshkruese të memorandumit të mirëkuptimit; së dyti, inkurajimin e bashkëpunimit në kuadër të përmirësimit të kualifikimeve të studentëve, të personelit akademik, të profesionistëve për nxitjen e mëtejshme të projekteve të përbashkëta në fushat e përfshira në memorandum.

Zoti Shkurti i shpjegoi në mënyrë të detajuar qoftë pjesëmarrjen ndër vite të studentëve, numrin e shkëmbimeve e të tjera. Për këtë arsye në përfundim të saj, në aspektin ligjor vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, prandaj si relator vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojnë në komision.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Përmeti!

A ka pyetje të nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi – Këtu flitet për një vlerë financiare prej 150 mijë euro. Në fakt, ky do të jetë fond direkt për studentët e ekselencës, apo do të jetë detyrimi që shteti shqiptar do ta ketë çdo vit deri në vitin akademik 2024-2025? Pra, ky fond do të jetë i përcaktuar për studentët e ekselencës, apo do të jetë një vlerë që kërkohet për t’ia dhënë Shteteve të Bashkuara të Amerikës?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Urdhëroni, zoti Tola!

Erzen Tola – Faleminderit, zoti kryetar!

Atëherë, masa prej 150 mijë eurosh është kontribut i shtetit shqiptar për pjesëmarrje në këtë program “*Fulbright*”, në bazën e të cilit ne bëhemi anëtarë me të drejta të plota për të shkëmbyer studentët, studiuesit dhe kërkuesit, por kjo masë pagese nuk i shtohet buxhetit të shtetit shqiptar, sepse është marrë nga fondi i ekselencës që akordohet nga shteti shqiptar çdo vit në masën prej 1,5 milionë eurosh dhe nga ky fond është tërhequr kjo pjesëmarrje në këtë program.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi – Afati i kësaj është deri më vitin 2024-2025?

Erzen Tola – Marrëveshja është nënshkruar për një afat 5-vjeçar me të drejtë rinovimi, por ka afat të përcaktuar. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Fino, a keni pyetje?

Bashkim Fino – Problemi është që kjo masë simbolike prej 150 mijë eurosh dhe në vazhdim, që nuk është asgjë, thuhet se hyn në fuqi në vitin 2019. Viti 2019 sapo ka mbaruar dhe ne jemi në procesin e miratimit të buxhetit të shtetit. E kaluam në parim dhe do ta kalojmë edhe nen për nen në datën 19. Domethënë, për vitin 2019 që mbaroi, janë ekzekutuar ato fonde që të jemi korrektë kur ta kalojmë dhe, në qoftë se nuk janë, të vihen në buxhet? Ky është thelbi.

Erzen Tola – Faleminderit, zoti Fino!

Ashtu siç e thashë, ne e kemi parashikuar edhe në PBA, edhe në buxhetin e vitit 2020 fondin e ekselencës prej 1,5 milionë eurosh brenda të cilit është edhe kjo masë pagese, kjo tarifë për t’u përfshirë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Tola!

Zoti Përmeti ka një pyetje.

Andi Përmeti – Kam një pyetje më shumë kurioziteti, me thënë të drejtën. Sa është numri i shqiptarëve që shkon për “*Fulbright*” në vit në Amerikë ose të paktën 2 vjetët e fundit, sepse ndoshta është i ndryshueshëm?

Erzen Tola – Në lidhje me numrin, siç është përcaktuar edhe në marrëveshje, ministria do të nënshkruajë me institutin një marrëveshjeje të nivelit të dytë për të gjitha modalitetet. Numri mund të jetë i ndryshëm, në varësi të nevojave të shtetit shqiptar apo edhe të mundësive

të programit “*Fulbright*” për t’i ofruar Shqipërisë, por në të gjitha rastet do të jetë një numër, i cili do të jetë me kosto shumë më të ulët se sa studentët ekselentë të cilët ne dërgojmë në botë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Tola!

Atëherë, e votojmë në parim. Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “*Fulbright*”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votimin në tërësi projektligjin.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Ftoj relatorin, zotin Përmeti dhe këshilltarin e komisionit që të bëjnë gati raportin për komisionin përgjegjës që më pas edhe ky projektligj t’i drejtohet seancës për votim.

Faleminderit, zoti Shkurti dhe zoti Tola!

Ditë të mbarë!

Të nderuar kolegë, këtu e mbyllim këtë pjesë të parë të mbledhjes së komisionit për të vazhduar me pjesën e dytë të mbledhjes së komisionit, e cila ka të bëjë me seancat dëgjimore në kuadër të shqyrtimit të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97, datë 4.3.2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918 , datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Përpara se të fillojmë me këtë rend ditë me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, i ftoj kolegët për 10 minuta pushim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.12.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në kuadër të shqyrtimit të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. (Komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Damian Gjikhuri, Bashkim Fino, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Përmeti, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti, Alban Zeneli, Ediola Braha, Nikolin Staka dhe Artemisa Malo

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Diana Malaj - mbulon çështjet e lirisë së informimit në_Qendra Res Publica

Saimir Vishaj - kryetar i Shoqatës së Avokatëve Penalistë të Shqipërisë

Alfred Bari - përfaqësues i Shoqatës së Avokatëve Penalistë të Shqipërisë

Edmond Petraj - përfaqësues i Shoqatës së Avokatëve Penalistë të Shqipërisë

Ylli Kamberi - përfaqësues i Shoqatës së Avokatëve Penalistë të Shqipërisë

Mevlut Derti- përfaqësues i Shoqatës së Avokatëve Penalistë të Shqipërisë

Shkëlqim Sulo - përfaqësues i Shoqatës së Avokatëve Penalistë të Shqipërisë

Ardita Kolmarku - juriste në Komitetin Shqiptar të Helsinkit.

Kristina Voko – Drejtoresha ekzekutive e BIRN Albanias

Klodiana Kapo – drejtoreshë ekzekutive e “Faktoje. Al”

Violeta Keta – redaktore në “Faktoje. Al”

Megi Ndregjoni - përfaqësuese e “Exit news”

Rezarta Çausi - përfaqësuese e “Exit news”

Monika Bixho – përfaqësuese nga OSBE-ja

Edlira Çanga - përfaqësuese nga OSBE-ja

Aleksander Çipa – përfaqësues nga Unioni i Gazetareve

Ulsi Manja – Mirëdita!

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe relator në të dy këto projektligje do të jenë kolegët Klotilda Bushka dhe Vasilika Hysi.

Të dy këto projektligje janë miratuar në parim. Kemi zhvilluar disa seanca dëgjimore, por ato u ndërprejnë për shkak të situatës së fatkeqësisë natyrore pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019.

Gjej rastin të shpreh ngushëllimet e sinqerta në emrin tim dhe të kolegëve të komisionit për jetët e humbura, për mijëra të tjerë të plagosur, por edhe për mijëra të tjerë që kanë humbur banesat e tyre, por njëkohësisht të garantojë edhe mbështetjen dhe solidaritetin e Komisionit të Ligjeve me familjet e viktimave të të dëmtuarve, por edhe të atyre që kanë humbur banesat, si dhe të garantojmë gjithë mbështetjen për qeverinë, që procesi i rindërtimit, por edhe i kalimit të pasojave dhe traumave të këtij tërmeti, të kësaj fatkeqësisë natyrore të kalojnë në një kohë sa më të shpejtë.

Sot rifillojmë seancat dëgjimore me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Janë prezentë në këtë seancë dëgjimore përfaqësues nga Qendra Res Publica, nga Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, BIRN Albanias, “Faktoje. Al”, “Exit news”, OSBE dhe nga Unioni i Gazetarëve.

Të dyja projektligjet janë votuar në parim në Komisionin e Ligjeve, bëhet fjalë për dy nismat e depozituara në Komisionin e Ligjeve në datën 9.7.2019, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit.

Ka edhe një draft të përmirësuar pas marrjes së ekspertizës më të mirë vendase dhe të huaj, të datës 20.11.2019, i cili u është shpërndarë kolegëve, por edhe publikut dhe të ftuarve dhe diskutimi që do të zhvillojmë, por edhe seance dëgjimore që kemi në vazhdim do të jenë rreth këtij drafti.

Jemi të hapur për çdo sugjerim, për çdo koment, për çdo ekspertizë vendase apo të huaj që i shërben përmirësimit të cilësisë së këtij projektligji.

Pas zhvillimit të seancave dëgjimore, jeni të lutur që përpos prezantimit tuaj në këtë dëgjese, t’i depozitoni materialet edhe me shkrim. Relatorët do t’i mbajnë shënim të gjitha opinionet dhe do t’i paraqesin në një formë table dhe në shqyrtimin dhe miratimin nën për nën

do të jetë Komisioni i Ligjeve si komision për dhënie mendimi e më pas komisioni përgjegjës, që do të bien dakord se cilat nga ato sugjerime që do të bëhen për këtë projektligj do të merren në konsideratë, në funksion të cilësisë së projektligjit.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

Kush e do fjalën?

Urdhëroni, zoti Çipa, nga Unioni i Gazetarëve!

Aleksandër Çipa – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, të nderuar deputetë për kohën që na vutë në dispozicion për të dëgjuar pretendimet tona për dy projektligjet!

Jam këtu në emër të një grupi organizatash gazetarësh, të cilat për korrektesë po i lexoj: BIRN Albania, Civil Rights Defenders, Citizens Channel, Faktoje, Instituti Shqiptar i Medies, Instituti Shqiptar i Shkencave, Këshilli Shqiptar i Medias, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Lidhja e Gazetarëve të Shqipërisë, Historia ime, Qendra Res Publica, Qendra Shqiptare Medialu, Qendra Shqiptare për gazetari Cilësore, Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë dhe Unioni i Gazetarëve Shqiptar.

Qëndrimin tonë të përbashkët dhe të unifikuar për dy projektligjet që janë duke u përgatitur nga komisioni juaj e shpreh përmes një deklarate, të cilën kam kënaqësinë ta lexoj.

Organizatat e gazetarëve dhe një pjesë e shoqërisë civile i bëjnë thirrje qeverisë të tërheqë dy projektligjet e prezantuara publikisht si “Paketa antishpifje”.

Gjithashtu, i bëjmë thirrje Kuvendit, që, në rast se qeveria nuk i tërheq këto projektligje, t’i rrëzojë ato menjëherë. Rëndësia që ka liria e shprehjes në një shoqëri demokratike reflektohet më mbrojtjen e gjerë që i jepet asaj në legjislacionin ndërkombëtar në nivel global dhe rajonal, përfshi këtu nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, nenin 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, nenin 19 të Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut, nenin 10 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, etj.

Amendamenti i parë në Kushtetutën e SHBA-së, i miratuar rreth 230 vjet më parë, më 15 dhjetor të vitit 1791, ndalon qeverinë të bëjë ligje që rregullojnë krijimin e feve, ndalojnë ushtrimin e lirisë fetare, që kufizojnë lirinë e shprehjes, lirinë e shtypit, të drejtën për t’u mbledhur paqësisht, si dhe të drejtën e peticionit ndaj qeverisë për të kërkuar kompensim.

Organizatat vërejnë se dy projektligjet, pjesë e “Paketës antishpifje”, i akordojnë AMA-s dhe AKEP-it, kompetenca gati gjyqësore, me natyrë sanksionuese ndaj operatorëve mediatikë, ndërkohë që këto organe, edhe pse të pavarura, sipas ligjit nuk ofrojnë garanci funksionale për të qenë efektivisht të pavarura, sikurse janë organet e pushtetit gjyqësor.

Shqipëria ka mjaftueshëm ligje, që rregullojnë çështjet kur media shkel të drejtat e të tjerëve dhe çdo ndërhyrje tjetër, si dhe në këtë drejtim ka pasur disa precedentë të gjykuar në sistemin tonë gjyqësor.

Nevoja për të pasur vetërregullim të medias dhe jo rregullim ligjor të saj, merr rëndësi të veçantë në ato shtete me demokraci në tranzicion, sikurse është vendi ynë, ku shpesh mediet janë të lidhura me interesat e njohura të biznesit, të partive politike. Vetërregullimi është kombinim i standardeve që përcakton kodet e duhura të sjelljes për medien, të cilat janë të nevojshme për të mbështetur lirinë e shprehjes dhe për të mundësuar që kjo sjellje të monitorohet dhe të mbahet e përgjegjshme. Vetërregullimi ruan pavarësinë e medieve dhe e mbron atë nga ndërhyrjet partizane të qeverisë.

Organizatave u bëjnë thirrje organizatave simotra në botë, dhe kësaj thirrjeje të organizatave tona u janë përgjigjur dy ditë më parë me një deklaratë gjashtë prej organizatave në të rëndësishme dhe prestigjioze në botë, që mbrojnë liritë themelore dhe në mënyrë të veçantë lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes në botë.

Zoti kryetar dhe të nderuar anëtarë të komisionit, ne si organizata gazetarësh dhe një pjesë e përfaqësuesve të shoqërisë civile, ju kërkojmë që ta merrni në konsideratë këtë kërkesë tonën.

Një ditë më parë, përfaqësuesi i lartë i OSBE-së ju është drejtuar, gjithashtu, me një lloj refuzimi, e cila analizon dhe shpreh substancialisht pretendimet që kemi ne për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe, natyrisht, për moskalimi e këtyre dy projektligjeve në këtë gjendje që janë paraqitur, material që na është vënë në dispozicion edhe neve, sepse mendojmë se kjo krijon një problematikë të panevojshme për realitetin e demokracisë dhe funksionin e pushteteve në demokracinë tonë.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

A ka përfaqësues të tjerë nga organizatat e shoqërisë civile, që duan të shprehen?

Aleksandër Çipa – Zoti kryetar, meqenëse unë kam edhe delegimin e përfaqësimit, po deklaroj se ne kërkujmë që deri në momentin që ju do ta merrni në konsideratë kërkesën tonë, të mos kemi më asnjë seancë të komunikimit.

Ulsi Manja – Pra, ju mjaftoheni me leximin e kësaj deklaratë?

Aleksandër Çipa – Reagimi ynë për të sjellë reagimin tuaj do të vazhdojë duke u larguar nga salla dhe, natyrisht, duke mbetur në aksionin e reagimit dhe të kërkesës sonë deri në dëgjueshmërinë nga ana juaj.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po pyetje a mund t’ju bëjmë?

Aleksandër Çipa – Ne nuk i shmangemi asnjë lloj komunikimi.

Ulsi Manja – Rendi i ditës së mbledhjes së sotme është seancë dëgjimore. Ne ju kemi ftuar t’ju dëgjojmë. Sigurisht, ne u njohëm me deklaratën që ju bëtë në emër të të gjithë organizatave që përfaqësoni, por deputetët kanë nevojë të bëjnë pyetje dhe të sqarohen për pretendimet tuaja, sepse këto dy projektligje janë në procedurë parlamentare dhe për sa kohë janë në procedurë parlamentare, nuk dalin nga procedura parlamentare pa u ezauruan i gjithë diskutimi, sipas Rregullores së Kuvendit.

Shoh që kolegët kanë nevojë për sqarime, kanë nevojë t’ju pyesin, sepse ju ngrini pretendimin që AMA dhe AKEP-i marrin kompetenca gati gjyqësore me këto dy projektligje, të paktën ky qe thelbi i të gjithë deklaratës. Ju kërkoni vetërregullim të këtij profesioni dhe jo rregullim me ligj, sepse ju e shihni në këndvështrimin e lirisë së medieeve, ndërkohë që këto dy projektligje dhe ky diskutim sot në komision e sheh edhe në këndvështrimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të qytetarit, se janë dy anë të së njëjtës medalje, pra duhen gjetur një ekuilibër, një balancë mes këtyre të drejtave. Gjithsesi, ne jemi të hapur për diskutim dhe për këtë kolegët e mi kanë pyetje, që të qartësohemi edhe ne.

Urdhëroni, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi – Përderisa ne jemi Komisioni i Ligjeve, unë mendoj se deklarata duhet të ishte objekt i Komisionit të Medies, dhe jo objekt i komisionit tonë.

Unë do të doja nga organizatat të dija se çfarë problematike shtrohet në raport me shkeljen e të drejtave. Këtu jam shumë i prerë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Unë e sqarova edhe në fillim, se Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi. Natyrisht që komision përgjegjës për të dy këto projektligje apo për “Paketën antishpifje” është Komisioni i Medieeve.

Unë e dëgjova deklaratën që lexoi zoti Çipa në emër të organizatave që ai përfaqëson dhe më duket se u referohet varianteve të para të projektligjit, që janë në faqen e Kuvendit, por, gjithsesi, kolegët e mi deputetë, janë të lirë për cdo lloj pyetjeje në drejtim të përfaqësuesve që kanë ardhur sot në seancë dëgjimore.

Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka - Faleminderit!

Faleminderit, për prezencën sot!

Sigurisht, është ushtrim i të drejtës së qytetarëve për të prezantuar shqetësimet e tyre në organin më të lartë që ushtron sovranitetin e popullit, siç është Kuvendi, dhe për këtë arsye ne

kemi vijuar me këtë tur dëgjesash dhe unë vlerësoj çfarëdolloj komenti apo shqetësimi që ju keni.

Nisur nga natyra e punës së Komisionit të Ligjeve dhe kompetencave të këtij komisioni, kam disa pyetje për ju. Me sa kuptoj, ju nuk keni bërë komente në lidhje me draftet e rishikuara, të cilat janë edhe drafte të përmirësuara në kuadër të konsultimit tonë me ekspertët ndërkombëtarë, por ju kërkon që ky ligj të mos hy fare në procedurë shqyrtimi. Për sa kohë, opinionet e OSBE-së apo të Komisionerit për Lirinë e Medies, që ju përmendët, kanë qenë online dhe tashmë është edhe një opinion i fundit i nëntorit, për të cilin besoj se jeni në dijeni (në qoftë se nuk jeni në dijeni, kemi bërë kopjo për secilin që është këtu prezentë), që japin komente të caktuara për çështje specifike në draftet që kemi, të cilat kërkojnë ende vëmendje dhe përmirësim, por që janë tashmë të minimizuara në krahasim me opinionet e para. Unë nuk kam qartësi tashmë, sepse kërkuat që ligji të mos bëhet fare, ndërkohë që dëgjesën e kemi kërkuar, që të paraqisni mendimet që keni në lidhje me këto drafte për çështje specifike. Nuk shoh të keni mendime, për sa kohë jeni që në fillim kategorik, që nuk e duam këtë ligj.

Supozojmë për një moment që jeni vetëm ju grup interesi, ndërkohë që kur ne bëjmë ligje, duhet të marrim në konsideratë balancimin e të drejtave të të gjitha grupeve të interesit. Ju kërkon të bëni zhvillimin dhe garantimin e këtyre të drejtave që kërkon gjithë shoqëria, jo vetëm një grup, nëpërmjet mekanizmit të vetërregullimit.

Sot në Shqipëri ka ligj, kur vjen puna për dezinformimin, për lajmin e rremë, për shpifje, subjektet të cilave u cenohet një e drejtë, kanë të drejtë të kërkojnë rivendosjen e të drejtës së tyre me rrugë gjyqësore në gjykatat civile ose në gjykatat penale.

Si do ta zgjidhë vetërregullimi bërjen efektive të këtyre mekanizmave që ne kemi në fuqi, kur subjekti ndaj të cilit drejtohet pretendimi i atij që i është shkelur e drejta për dinjitet në sajë të një lajmi të rremë, kur pala tjetër (që zakonisht nëpër gjykime është ose i padituri, ose personi i akuzuar) nuk ekziston e regjistruar në asnjë regjistër publik?

Pra, si e zgjidh këtë gjë vetërregullimi? Besoj se ju i keni lexuar të gjitha opinionet e OSBE-së dhe të ekspertëve të tjerë, për këtë çështje unë nuk shoh, që në kuadrin e vetërregullimit ne të kemi një zgjidhje. Pra, unë po e marr shëmbëllimin për një çështje konkrete, pra rastin kur një qytetar i dëmtuar shkon në gjykatë dhe nuk gjen dot se kush është i padituri, ku është regjistruar i padituri.

Një grua e dhunuar, që sipas ligjit nuk duhet t'i zbulohet identiteti, se është viktimë, i del emri në një portal që nuk është i regjistruar. Ku do ta kërkojë rivendosjen e të drejtave? Si do të parandalohet dëmi i kësaj zonje? Le pastaj po të flasim për fëmijët. Nuk po hyj te çështjet

e pornografisë së fëmijëve, nuk po flas për gjuhën e urrejtjes, nuk po flas për çështjet e sigurisë, se këtu nuk besoj se jeni kundër, se po të ishit kundër edhe për këtë nuk do të pranoni.

E kam vetëm për çështjen e të drejtave civile të qytetarëve për të pasur të drejtën e jetës, të dinjitetit dhe të rivendosin dëmin që pësojnë nga këto veprimtari, të cilat kanë ndodhur dhe ndodhin në Shqipëri ashtu siç ndodhin në çdo vend të botës, dhe unë nuk shoh që këto gjëra t'i zgjidhë vetërregullimi.

Në qoftë se ne do të kishim një autoritet, i cili do të krijonte, në përputhje me të gjitha standardet, regjistrimin dhe jo detyrimin për të pasur ngarkesa tatimore, fiskale që ndërhyjnë në çështjet e lirisë së medias, sepse ne e dimë se media duhet të jetë e lirë, çka do të thotë se nuk mund t'i vëmë barriera fiskale apo financiare, por detyrime regjistrimi, pa pasur detyrimin që të kenë pagesa, licenca apo numër të caktuar kriteresh që e pengojnë, qoftë edhe një person, të shprehë lirisht mendimin e vet në kuadër të sektorit të medias, cili mund të ishte një mekanizëm që i rregullon edhe të drejtat e qytetarëve për të rivendosur dëmin që u është shkaktuar nga shpifja, nga dezinformimi, nga lajmi i rremë pa cenuar të drejtën e medias dhe lirinë e shprehjes?

E fundit, në qoftë se thoni se duhet të jetë patjetër gjykata ajo që vendos, ku thuhet në draft se nuk është gjykata? Nëse e lexoni draftin, versionin e sotëm, të gjitha palëve u jepet pa diskutim e drejta e aksesit në gjykatë, se ndryshe do të ishim në kushtet e absurditetit.

Cilat janë konkretisht ato pengesa që draftligjet i vendosin medias?

Ulsi Manja - Faleminderit!

Urdhëroni!

Kristina Voko – Unë përfaqësoj BIRN Albanian.

Sigurisht që ngritët shumë çështje. Po e nis me pyetjen që bëri zoti Ulsi. Ne jemi një nga grupet e interesit dhe përfaqësojmë lirinë e medias ose interesat e medias.

Në fakt, do të thosha se të gjitha deklaratat tona, jo vetëm kjo deklaratë, i referohen lirisë së shprehjes dhe ajo është një e drejtë themelore e njeriut, kështu që, të mos i keqkuptojmë.

Pra, këtu asnjë nga përfaqësuesit e grupit nuk foli për interesat e medias, por foli pikërisht për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ashtu siç përmenden në të gjitha konventat që ishin parashtruar.

Porsa i përket ndërhyrjes nëse po flasim për draftin e parë, të dytë, të tretë, të katërt, po, keni shumë të drejtë, ka pasur shumë drafte, por ju siguroj se reagimi ynë është i bazuar dhe i përditësuar në bazë të të gjithë drafteve që ju keni bërë. Kur them ju, më vjen keq, por kuptohet, institucionet përgjegjëse që i kanë prezantuar këto dy projektligje, duke nisur nga dhjetori i

vitit të kaluar, kohë gjatë së cilës ishim në seancat dëgjimore, me të gjitha versionet e tjera, të mbajtura fshehtë dhe të kaluara pa asnjë procedurë konsultimi publik, që janë të detyrueshme për institucionet, para se t'i sjellin projektligjet në këtë sallë.

Sigurisht, reagimet janë mbi draftin e përmirësuar, që ju thatë: me ekspertët ndërkombëtarë. Nuk e dimë cilët janë këta ekspertë. Të mos harrojmë se pas këtij drafti të përmirësuar, ne i kemi dërguar Kuvendit një kërkesë, në emër të të gjitha organizatave, për të bërë transparencë në lidhje me procedurën e konsultimit e të përmirësimit të të dyja draftligjeve, kërkesë për të cilën nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ana e Kuvendit. Më falni, morëm përgjigje refuzuese, por nuk u dha asnjë informacion se si është kryer procedura.

Nuk e dimë se cilët janë ekspertët ndërkombëtarë që janë përfshirë, po për sa i përket reagimit, nëse nënkuptoni zyrën e Vjenës, të OSBE-së, *legal review*-në e tyre, rishikimi ligjor u publikua vetëm dje. Kësisoj, prej tyre nuk ishte qëndrim i unifikuar dhe as përfundimtar, deri në momentin kur ju e quani atë draft të përmirësuar.

Kjo është qasja jonë, por të mos harrojmë se nuk është aspak e ndryshme nga të gjitha kërkesat që kanë ardhur dhe janë dëgjuar këtu më datën 25 nëntor, qoftë nga OSBE-ja, qoftë nga Këshilli i Europës, qoftë nga Bashkimi European, qoftë në letrën drejtuar këtij komisioni nga ana e Komisionerit të Lartë të të Drejtave të Njeriut, të Kombeve të Bashkuara, si dhe të gjitha organizatave ndërkombëtare të lirisë së medieve, të cilat dje ju drejtuan sërish këtij komisioni përmes një letre të hapur publike.

Pra, reagimet tona këtu nuk vijnë si vështrim i kundërt me të gjithë parafolësit, me të gjithë ekspertët ndërkombëtarë e me të gjitha grupet e tjera të interesit, por keni të drejtë kur thoni se ne i kundërshtojmë në parim. Po, i kundërshtojmë në parim, dhe ky ka qenë qëndrimi ynë që në momentin e parë, që në dhjetor. Kundërshtojmë në parim që të jenë dy institucione publike, fatkeqësisht ende të varura, gjë të cilën e keni të reflektuar në të gjitha raportet ndërkombëtare, pavarësisht statusit të tyre si institucione që duhej të ishin të pavarura, e këtu po flas për AMA-n dhe AKEP-in, të cilat të rregullojnë dhe të vetëcensurojnë e medies.

Përmbajtjet kryesore dhe ndryshimet kryesore që ju propozoni, lidhen pikërisht me këtë, nuk lidhen me rregullimet. Sa i takon regjistrimit, nëse është ky shqetësimi kryesor i këtyre dy projektligjeve, ju siguroj se ndryshimet e fundit që janë bërë në procedurat e AKEP-it vjet, në verë, në vitin 2018, e kanë siguruar regjistrimin e çdo portali, përmes të dhënave të detyrueshme që mblidhen për hapjen e një *domain*-i. Rasti më konkret që mund të marr, është se AKEP-i ishte shumë i aftë të identifikonte me emra, me e-maile, të gjitha mediet online, për të dërguar kërkesën e publikimit të detyrueshëm të llogarive bankare, ku duhej mbështetur *e-Albania*. U bë brenda gjysmë ore, dhe regjistri ekziston. Regjistri ekziston i detajuar. Nuk besoj

se është procedurë, që një grua e dhunuar ose kushdo tjetër, të gjejë dhe të identifikojë median përkatëse. Ashtu sikundër nuk po flasim për pornografinë dhe sigurinë kombëtare, të cilat janë të rregulluara tashmë në shumë ligje të tjera, në Kodin e Procedurave Penale, e kështu me radhë, që janë shumë më lart si ligje, dhe deri më tani AKEP-i ka qenë shumë i aftë t'i identifikojë dhe të mbyllë ato faqe, të cilat kanë bërë shkelje të tilla.

Pra, ai aspekt është më se i rregulluar. Nuk e rregullon ky ligj pjesën e regjistrimit. Nuk e besoj se ju keni pasur shqetësime dhe nuk keni arritur të mbyllni një medie të caktuar, si dhe të identifikoni se kë do të hidhni në gjyq.

Sa i përket shqetësimit tuaj të dytë, se cila është pala, pala ai që e ka hapur këtë faqe, që është e regjistruar, dhe kjo tashmë ekziston në procedurë. E thashë: pyesni AKEP-in. Nëse përfaqësuesit e AKEP-it këtu thonë se e kishin të pamundur të identifikonin përmes e-maileve dhe detyrimit konkret, për të publikuar të dhënat bankare të *e-Albanias*, në lidhje me mbledhjen e fondeve, mund ta pranojmë si justifikim, dhe kam përshtypjen se të gjithë iu përgjigjëm atij detyrimi, që u konsiderua njerëzor.

Për sa i përket vetërregullimit, se cili është modeli i vetërregullimit, në të vërtetë, fakti se cilat janë modelet e vetërregullimit nëpër botë mund të hante një seancë diskutimi shumë të gjatë. Ka modele nga më të ndryshmet, shumë prej të cilave funksionojnë më së miri dhe janë shumë efikase edhe në vendet fqinje si Kosova, Bosnja e kështu me radhë.

Unë nuk njoh asnjë vend tjetër, që ta ketë bërë në këtë mënyrë, siç e keni bërë ju, përveç Rusisë së Putinit.

Pra, këtë model, ku mediet dhe përmbajtja e tyre të gjykohej e të rregullohet nga dy institucione publike, nuk e kemi gjetur gjëkund. Vetërregullimi ka modele nga më të ndryshmet. Vetërregullimi nuk ia heq të drejtën qytetarit që të shkojë në gjykatë. Vetërregullimi është një hap paraprak, i cili u jep medieve mundësinë që të vetëpërmirësohen, të adresojnë ankesat e qytetarëve pa kosto, pa avokat, pa procedura të gjata gjyqësore.

Nëse doni të flasim në detaje se si funksionon vetërregullimi nëpër botë, ju lutem të na informoni dhe jemi shumë të gatshëm ta bëjmë këtë gjë.

Megjithatë, po i rikthehem prapë thelbit: ashtu si në të gjitha deklaratat tona të mëparshme, ne si organizata i refuzojmë në parim këto dy ligje. Pse? Sepse problematika kryesore është kontrolli, përmes AMA-s dhe AKEP-it, i përmbajtjes së medieve online, dhe duke qenë se ne nuk kemi përcaktime të qarta në legjislacionin tonë, se cilat quhen medie online, përfshijmë këtu të gjitha publikimet online, përfshijmë këtu blogje personale, përfshijmë këtu faqe të organizatave, përfshijmë këtu çfarëdolloj faqeje elektronike.

Kështu që, jemi kundër në parim. Përderisa detyrimet u jepen AMA-s dhe AKEP-it, ne jemi parimisht kundër shqyrtimit të këtyre dy projektligjeve në parlament.

Unë e kuptoj që, mbase kërkesa jonë mund t'ju duket e tepërt, por ky ka qenë një qëndrim i unifikuar dhe i vazhdueshëm i joni, i organizatave ndërkombëtare, që nga dhjetori i vjetshëm e deri ditën e fundit, në lidhje me cilindo nga draftet e prezantuara.

Faleminderit!

Aleksandër Çipa – Edhe diçka tjetër.

Ulsi Manja – Po, zoti Çipa.

Aleksandër Çipa – Ne mendojmë se kalimi nga bordi i AMA-s në Këshillin e Ankesave, është një praktikë, e cila ka rezultuar jo e suksesshme dhe jo efiçente. Siç e dini, dikur bordi i AMA-s zgjidhej me propozimin e organizatave, dhe në këtë listim të propozuesve përfshihehin më shumë se 67 organizata, madje edhe organizata të cilat s'kanë as vokacion profesional e as vokacion përfaqësuesi. Dy palët kryesore, në bazë të preferencave të tyre në bordet e AMA-s zgjidhnin përfaqësues, të cilët praktikisht, karakterizoheshin nga anshmëria dhe nga shërbësaria e palëve me konflikt interesi, që janë palët politike.

Kjo praktikë parashikohet të procedohet e të zhvillohet edhe në rastin e zgjedhjes së Këshillit të Ankesave. Kjo është një ndër arsytet, që mendohet se mishëron një defekt në projektligjin që ju na keni paraqitur.

Pjesa tjetër e ankesave, nga informacioni që kam në cilësinë e drejtuesit të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, prej vitit 2010 e deri në vitin 2019, në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë ka procese gjyqësore të zhvilluara e të kaluara në nivelet e gjykimit, në lidhje me raste të fyerjes, raste të prishjes së imazhit, si dhe aspekte të tjera. Pra, legjislacioni aktual e kryen funksionin e mosshpërfilljes së të drejtës juridike të tjetrit, të palës që ankohet.

Pjesa tjetër, që lidhet me një pretendim të posaçëm ndaj draftit, ka të bëjë me faktin... Ju e dini shumë mirë se ka pasur disa drafte, në dy prej të cilëve nuk parashikohej e drejta e ankimit të vendimit të AMA-s në gjykata. Tani kjo është korrigjuar, gjë që është bërë falë presionit të zhvilluar nga organizatat tona dhe organizatat ndërkombëtare. Kjo vlerësohet edhe në letrën që përfaqësuesi i lartë i OSBE-së i ka përcjellë zyrtarisht qeverisë shqiptare një ditë më parë.

Aspekti tjetër ka të bëjë përsëri me faktin se cilat janë grupet e interesit. Në qoftë se do të pranojmë konceptin e pluralitetit të pushteteve në demokraci, ne jemi një ndër ata të pretenduar. Defektet tona janë pjesë e ndërgjegjes sonë profesionale, por problemi që shtrohet, është se këtë defekt ne e kërkojmë të inkurajimi që ju duhet t'u bëni mekanizmave vetërregullues, sepse vërtetë që tek ne ekziston një ndërgjegje vetërregulluese. Mekanizmat

ekzekutues vetërregullues lënë për të dëshiruar. Ne shprehim vullnetin që, duke pasur parasysh këtë domosdoshmëri, t'i inkurajojmë këto. Po si mund t'i inkurajohen ato? Mund të inkurajohen duke përfshirë në Këshillin e Ankesave të AMA-s jo persona që i zgjedh parlamenti, mbi bazën e besueshmërisë reciproke të palëve të dakordësuara politike, por mbi kuotën dhe mbi meritokracinë deontologjike, profesionale, që ne e kërkojmë.

Pra, organizatat që kanë një investiment publik dhe profesional, që kanë një aset të profesionalizmit e të kualifikimit profesional, të propozojnë anëtarët për në Këshillin e Ankesave, dhe zgjedhja e tyre të bëhet në bazën e këtij principi, jo mbi bazën e besueshmërisë apo afinicionit që mund të kenë me palën në pozitë apo me palën në opozitë.

Ky është koncepti ynë për vetë rregullimin.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çipa!

Vetëm një sqarim lidhur me letrën, me kthimin e përgjigjes që kemi marrë si Komisioni i Ligjeve.

Të gjitha opinionet e dhëna nga ekspertët e OSBE-së janë në faqen online, në faqen e OSBE-së. Sigurisht, Komisioni i Ligjeve nuk ka asnjë opinion tjetër përtej atyre opinioneve, që ata i kanë bërë publike në faqen e vet online. Që ta thjeshtësojmë problemin, sepse del sikur qarkullojnë shumë drafte, shumë opinione, shumë gjëra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, të lutem!

Jam shumë korrekt në lidhje me këtë pjesë, sepse janë dy projektligje, të cilave po u kushtojmë orë të pafundme diskutimesh, dhe ndjehemi shumë të lumtur që po e bëjmë këtë. Sepse, në fund të fundit, këtu nuk jemi njëra palë kundër tjetrës, por jemi të gjithë bashkë, për një ligj, i cili do të kënaqë interesat e publikut, por edhe të të gjitha palëve, në fund të fundit. Nuk po bëjmë një ligj, me cilin mund të cenomë lirinë e medieve apo vetërregullimin e këtij profesioni. Zonja e tha shumë qartë: këtu bëhet fjalë për të drejtën e shprehjes, që është e drejtë universale. Aty rrotullohemi të gjithë, por unë nuk mora përgjigje për pyetjen se si e garanton vetërregullimi aksesin e qytetarit të cenuar në gjykatë. Në lidhje me këtë nuk kam marrë përgjigje deri më tani. Sepse, flisni pa fund për procese në gjykatë, por asnjë prej jush nuk më thotë nëse ka ndonjë produkt gjyqësor konkret, ndonjë vendim konkret gjykate lidhur me këtë gjë.

Aleksandër Çipa – Ka disa, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Të lutem, të lutem!

Sepse, sot ka procese pa fund në gjykatë, të cilat shtyhen për shkak të mosparaqitjes në gjykatë të personit të paditur, të palës së paditur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Sepse nuk gjendet realisht. Nëse ka një aspekt të pambuluar në ligj, ndoshta ky ligj pikërisht këtë synon: të garantojë aksesin e palëve në gjykatë. Kështu mund të garantohet më mirë e drejta e shprehjes, them unë, sepse ka pa fund subjekte, për të cilat hidhet baltë dhe shpifje nga mëngjesi deri në darkë, dhe sigurisht që kemi një kuadër ligjor edhe për shpifjen, absolutisht dakord; e kemi një kuadër rregullator, po kur vjen problemi për ta rivendosur këtë të drejtë të shkelur në gjykatë, ashtu siç pretendon personi i cenuar, ka vështirësi për ta zgjidhur në rrugë gjyqësore, sepse mungon pala e paditur.

Ndoshta ju nuk e keni këtë shqetësim, por ata që janë përplasur në dyert e gjykatave, të cilët janë qytetarë të Republikës së Shqipërisë njëlloj si ju dhe si ne, e kanë këtë shqetësim, sepse në emër të së drejtës së shprehjes askush nuk ka të drejtën të cenojë familjet shqiptare e as të ndajë në copa familjet shqiptare, thjesht dhe vetëm në emër të së drejtës së shprehjes, siç ishte e drejta e shprehjes për ato mijëra qytetarë shqiptarë, të cilët në tërmetin e 21 shtatorit dolën rrugëve të Tiranës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, të lutem, se e ka kërkuar fjalën për pyetje, kolegu Hyseni.

Kristina Voko – Meqë m'u drejtuat me pyetje.

Ulsi Manja – Patjetër!

Dhe mijëra të tjerë, pastaj, të cilët janë nën ankthin pa fund të tërmetit, që do të bjerë sonte pesë ballë, e do të bijë nesër mbrëma shtatë ballë. Kësisoj, këtu nuk po flasim për palë, por jemi të gjithë në një tryezë, me shqetësimin e vetëm të gjetjes së një balance ndërmjet të drejtës së shprehjes, lirisë së medieeve, por edhe në emër të rivendosjes së të drejtave të qytetarëve, të cilët mendojnë se u cenohen të drejtat në rastin konkret. Përveç kësaj, askush nuk ka qëllim tjetër.

Kristina Voko – Ndoshta herën e parë përgjigja ime nuk ishte e mjaftueshme. Unë mendoj se lidhur me regjistrimin u shpreha më së qarti. Thashë se AKEP-i e ka kaluar tashmë atë procedurë, dhe se që nga viti i kaluar, siç mund ta mbani mend, nxorëm edhe një listë prej 44 portalesh, të cilat nuk i gjenim në atë moment. Kishte një konfuzion ligjor në lidhje me faktin se ku regjistrohen organizatat dhe ku regjistrohen bizneset në këtë vend, por këto janë defekte të institucioneve tona dhe të mosnjohurisë së tyre.

Lidhur me regjistrimin, unë e thashë dhe e mora edhe si shembull. Që nga ai moment, të gjithë operatorëve të licencuar nga AKEP-i, të cilët bëjnë regjistrime në domain, u është

kërkuar që, për të mbajtur domainin, që mund të jetë parlament.al ose kryeministria.gov.al, duhet të hedhësh brenda të gjitha të dhënat, e me kartë identiteti.

Këtë e keni rregulluar vjet, me një procedurë. Ka shumë mundësi të ketë kaluar edhe nga ky komision. E thashë, e mora edhe si shembull: nuk besoj se AKEP-i, po të ishte këtu, do të raportonte ndonjë vështirësi në lidhje me gjetjen në këtë moment. Sigurisht, ai lë gjashtë muaj kohë e kështu me radhë, kohë e cila nuk ishte e ezauruar kur ju nisët procedurën e hartimit të dy drafteve të para në dhjetor të vitit të kaluar. Kështu që, a jeni shumë të sigurt se qëllimi kryesor është regjistrimi? Nëse është regjistrimi, atëherë pse nuk po flasim këtu për një ndryshim dhe përditësim të ligjit të AKEP-it, por po përfshijmë AMA-n? Si ndërhyrë AMA vetëm në regjistrimin dhe identifikimin e personave përgjegjës, për t'i çuar në gjykatë? Jo, AMA-s i keni lënë përgjegjësi për të vlerësuar përmbajtjen e medias. Këtë përgjegjësi nuk e ka asnjë institucion publik në asnjë vend tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse tjetri thotë se ky është i paanshëm, nuk është objektiv, sigurisht që do të vlerësoj përmbajtjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aleksandër Çipa – Po, neni 132.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kristina Voko – Lidhur me gjykatat, s'besoj se nuk ka media, të cilat s'janë çuar në gjykatë. Edhe neve na kanë çuar. Doni raste konkrete? Mund t'ju bëjmë një listë shumë të gjatë. Edhe Kryeministri ka çuar. Nuk besoj se ka pasur vështirësi për t'i identifikuar gazetarët, të cilët ai i ka paditur në gjykatë në lidhje me fondin e edukimit, e kështu me radhë.

Nëse është bërë një vlerësim paraprak, për të cilin kemi raste konkrete se sa herë ka pasur problematikë të mosçuarjes së një medie në gjykatë, për shkak të paaftësisë për të identifikuar se kush fshihet pas tyre, ju lutem ndajeni, nëse ka një vlerësim konkret. Sillini ato raste, ato statistika, në të cilat mediet nuk janë identifikuar, dhe kjo procedurë vlen për këtë.

Lidhur me qëndrimin tonë për refuzimin në parim, kam përshtypjen se edhe ndërkombëtarët, që i kishit këtu më datën 25 nëntor, kanë të njëjtin qëndrim. Pyetja e fundit ndaj tyre, ishte nëse duhen bërë përmirësime apo jeni kundër. Përgjigja që morët, së paku nga eksperti juridik i Këshillit të Europës, ishte se këto dy projektligje e kanë problemin me thelbin. Është thelbi ai që nuk po arrihet të justifikohet dot, jo përmbajtja, jo përmirësimi, jo fakti se në çfarë neni doni të bëni një ndryshim, jo nëse po flitet për 48 orë apo për 72 orë. Është qëllimi. Më vjen keq, por qëllimi nuk diferencon aspak nga qëllimi që ka pasur gjithë censura e kohës së komunizmit e kështu me radhë.

Aleksandër Çipa – Zoti kryetar, ju na pyetët, por ne ishim përgatitur të mbeteshim te deklaratat, me besimin se do të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ne nuk jemi nga ata që ikin. Jemi nga ata që shpesh qëndrojmë. Jemi rezistentë. Ne duam t'ju përcjellim mesazhin se, jo vetëm që e kemi përvetësuar tekstin e dy projektligjeve, por jemi të gatshëm të bëjmë një recensë interpretuese e juridike të këtij teksti.

Janë dy çështje, për të cilat ne shprehim argumentin se këto krijojnë problem edhe me direktivën e Komisionit European. Së pari, atributet që u jepen Këshillit të Ankesave dhe procesi që ndiqet pas penalteteve që do të japë AMA apo Këshilli i Ankesave, duke e lidhur me rrjetin e përmbarimit, është gjithashtu një çelës, i cili krijon prangosje për editorin e medieve online dhe për poseduesit e medieve online.

Nga ana tjetër, penaltetet financiare që parashikohen në nenin 29, në nenin 133, pavarësisht se ju keni bërë ndryshime, këto janë kuota financiare të larta për çdo posedues të një *online*-i në Shqipëri. Më duhet t'ju them se përgjithësisht, pjesën më të rëndësishme të medieve *online*, i drejtojnë dhe i posedojnë gazetarë, të cilët nuk kanë burime financiare për t'i përballuar, jo të gjitha, sepse nuk mund të bëj përgjithësime, por një pjesë e tyre. Këtu kam parasysh mediet *online* që kryejnë edhe atributet e medias lokale. Kjo është shumë e rëndësishme. Nuk mund të përfshihet në të njëjtin penaltet një medie *online* në Libohovë apo në Kukës me një medie *online* që funksionon në Tiranë. Këto penaltete financiare janë të dëmshme dhe që në leximin tonë privojnë lirinë e fjalës dhe lirinë e shprehjes përmes medieve të reja.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Çipa!

Fjalën e ka kërkuar zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar përfaqësues të medieve,

Ne jemi të nderuar sot, pasi kemi mes nesh zërin e ajkës së gazetarisë shqiptare. Prandaj reagoval në fillim, kur ju pretenduat: “Po vijmë me një deklaratë dhe po ikim”, sepse ne e kemi pritur me padurim këtë seancë për të dëgjuar realisht problemet nga ju. Ne mendojmë se askush më mirë se ju nuk e di ku pikon çatia e medias nga këndvështrimi profesional. Këtu mund të ndajmë opinionet duke shprehur qëndrimin tonë, se nuk jemi vetëm për t'u mbrojtur ju, roli ynë është që të mbrojmë edhe qytetarët e zakonshëm, qoftë edhe nga një pakicë e papërgjegjshme e medieve. Qoftë edhe një qytetar nëse do të nëpërkëmbet në të drejtat e tij, ne kemi detyrimin moral dhe kushtetues për ta mbrojtur. Prandaj duhet të na mirëkuptoni nëse ne jemi këtu edhe kritikë në disa qëndrime.

Nga ana tjetër për sa i takon draftit, jemi të interesuar dhe kolegët e mi, që të dimë nga ju, sepse jeni pak kontradiktorë, më falni që jua them: jeni kundër rregullimit në total me atë që lexova në deklaratë: “Rrëzoni ligjin, përndryshe ne ikëm! apo jeni kundër mekanizmave sikurse e thatë në fjalën tuaj?

Jam dakord, mund të mos jenë perfekt. Hajdeni t’i shikojmë! Prandaj është dëgjesa këtu. Ka pasur tryezë, unë kam qenë atje, më duket se ka qenë edhe zoti Çipa, një tryezë konsultimesh përpara se të vinin draftet, ka pasur organizime të shoqatave të ndryshme për opinionet. Mund të mos ketë qenë perfekt. Hajdeni ta analizojmë! Ne jemi këtu, por nuk mund të etiketohemi me gisht, kur sapo e kemi marrë detyrën. Sot po fillojmë detyrën tonë: shqyrtimin e një drafti që ka ardhur zyrtarisht. Mund të jetë një draft i papërshtatshëm, e hedhim poshtë, mund të jetë një draft, i cili ripunohet dhe përmirësohet dhe votohet. Hajdeni të bëjmë këtë gjë që kemi në dorë, por pa na paragjykuar. Ndajeni opinionin, nëse mendoni se ka mekanizma që nuk janë zgjedhur perfekt, keni një relatore që është e hapur për çdo problem. Të gjithë ne jemi gati të bashkëpunojmë, të formulojmë më të mirën e mundshme. Besoj se ndajmë së bashku shqetësimin, nuk mund të jemi kundër mosrregjistrimit të subjekteve. Ju duhet t’ia bëni të ditur publikut se ka subjekte të regjistruara me *domene* të huaja. Cili është qëllimi që një medie shqiptare të regjistrohet me *domen* të huaj të pa identifikueshëm? Ju e dini shumë mirë që ekziston. Unë mund t’ju jap listën, por nuk është ky synimi. Cili është synimi që medie të caktuara që ushtrojnë veprimtarinë në Shqipëri janë të regjistruara jashtë Republikës së Shqipërisë? Këto vijnë erë jo të mirë. Pa i paragjykuar përmbajtjen, por ne kemi detyrë të bëjmë rregullimin. Asnjë e drejtë nga korpusi i të drejtave të lirive dhe të drejtave të njeriut nuk lihet pa rregulluar.

Ju ftoj të mos i merrni të copëzuar shembujt nga vendet më demokratike të botës. Të gjitha vendet demokratike të botës kanë rregullim të të drejtave dhe lirive, si dhe asaj të shprehjes. Liria e shprehjes, është liria e çdo qytetari, kurse liria e medias, e informimit është liri e rregulluar. Në Kushtetutën tonë thuhet se mund të rregullohet nëpërmjet frekuencave apo licencimeve të ndryshme. Në momentin që rregullohet ka edhe një ligj, i cili do të ketë mekanizmat e kontrollit. Hajdeni t’i rregullojmë këto mekanizma. Besoj se nuk jeni kundër që disa medie, në kuptimin figurativ maxhoranca, Kryeministri i ka quajtur kazanë. Janë kazanë dhe tej kazanit, për sa kohë që ju dëmtojnë ju në radhë të parë, mediet e shëndosha, ju bëjnë me baltë, ashtu sikurse ka njerëz të korrumpuar në politikë, të cilët bëjnë me baltë të gjithë pjesën tjetër. Duhet t’i ndajmë. Ka ardhur koha të ndajmë medien e shëndoshë, medien serioze, që mund të bëjë edhe gabime në punë, dhe ato korrigjohen qoftë me mekanizma administrativë,

qoftë në gjykatë. Askujt nuk i mohohet e drejta me këtë ligj që të shkojë në gjykatë. Mos të abuzojmë me këtë të drejtë. Në fund shkohet në gjykatë.

Çfarë ka dashur të bëjë ky draft, pa e mbrojtur, nuk po bëj avokatin? Synimi ka qenë që qytetarët e thjeshtë të mos presin 3 apo 5 vjet përfundimin e gjykatës. Ky është realitet dhe nuk është vetëm shqiptar. Në Francë për të shkuar në Gjykatën e Lartë duhen 7-9 vjet, në SHBA-të është 7-12 vjet. Mos t'u themi qytetarëve që ne jemi mbrapa dhe për të mos e lënë qytetarin që të drejtën ta gjejë pas 5-7 vjetësh është gjetur një mekanizëm administrativ, i cili nuk i mohon të drejtat medias. Nëse mediet nuk janë dakord me vendimin e organit administrativ, atëherë le të shkojnë në gjykatë, por mund ta gjejnë të drejtën. Kur ka logjikë, kur është e zeza mbi të bardhë se ka shkelje, mund të mbyllet aty konflikti. Kjo zgjidhet ose me një penaltitet ose me rivendosjen e të drejtës.

Çfarë thotë drafti? Qytetari i drejtohet medias kur mendon se i është shkelur e drejta. Nëse nuk merr përgjigje shkon te bordi i ankesave. Çfarë ka ndodhur deri sot? Shumica e medieeve, po jua them këtë nga studimet, nuk u kanë kthyer përgjigje individëve, fare. Përgjigje ato seriozet. Nuk kthejnë përgjigje dhe moskthimi i përgjigjes jo se e ka ndaluar qytetarin të shkojë në gjykatë, por tregon një element papërgjegjshmërie. Ata që e kanë sjellë janë përpjekur ta heqin këtë element. Nuk është perfekt, mund ta korrigjojmë. Deri tani ka pasur vetëm një ndërhyrje nga zonja, që tha disa elemente juridike. Këtu duhen elemente konkrete juridikë. Ju ftoj që t'i sillni me shkrim, por edhe këtu të thoni: drafti, neni 4, pika 2, çalon, bie ndesh me të drejtat, shembulli është bazuar në Kushtetutë, në këtë praktikë të këtij apo atij vendi. Neni kaq bie ndesh me të drejtat themelore të informimit apo me lirinë e shprehjes. Për këto arsye, sepse na ndihmoni ne. Ne do t'i lexojmë me vëmendje dhe mund të gjëmë shumë elementë edhe vetë, por ju jeni përditë në terren dhe mund të na iluminoni me gjëra konkrete në lidhje me draftin. Prandaj, ju ftoj që të na ndihmoni duke qenë konkretë në draft. Mund të jenë 10 dispozita të papërshtatshme që t'i korrigjojmë, mund të jenë 20, është e drejta juaj. Mund të thoni se janë të gjitha. Nuk e besoj, se një pjesë e tyre janë deklarative, një pjesë janë orientuese, disa janë sanksionuese. Hajdeni t'i rregullojmë! Në këtë aspekt ju ftoj të diskutojmë ashtu siç e meritoni ju, por besoj se e meritojmë edhe ne profesionalisht. Pa emocione, të ndajmë ato gjëra që janë për t'u diskutuar në këtë tryezë. Nuk do të jetë e fundit. Do të jetë komisioni tjetër, që është komisioni përgjegjës, por në këtë komision, që ka të bëjë me të drejtat e njeriut, Komisioni për Ligjet, por edhe për të Drejtat e Njeriut, jemi shumë të interesuar të dëgjojmë konkretisht aspektet që bien ndesh me misionin tuaj fisnik.

Nga ana tjetër të ruajmë dhe raportin me ata që janë shumicë, krahasuar me ju, janë shumicë krahasuar me ne që është populli shqiptar, qytetarët e thjeshtë, që presin që nga të

drejtat dhe liritë e rregulluara të mbrohen, të mbrohen në të drejtën e tyre sa e lejon korniza kushtetuese.

Në këtë aspekt do t'ju ftoja dhe bëra pyetje që të na përgjigjeni më konkretisht.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Hyseni!

Kristina Voko - Jam shumë dakord që të mos jemi emocionalë. Pikërisht gjatë gjithë diskutimit dhe shembujve konkretë që janë marrë nga të gjithë anëtarët e komisionit, nuk doja të ndalesha të pjesa e popullit, qytetarët e thjeshtë, viktimat e dhunës, ata të shkretët e kështu me radhë. Mendoj se ligjet duhet të garantojnë të drejtat dhe shteti duhet të mbrojë të drejtat e gjithsecilit në këtë vend. Liria e shprehjes ashtu si liria e shtypit dhe medias janë dy ndër këto të drejta thelbësore. Fakti që ne nuk i bëjmë me tone emocionale deklaratat tona, nuk besoj se aludon se jemi më pak të ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka: media të mos abuzohet dhe të mos shkelë të drejtat e njeriut, ashtu siç jemi të ndërgjegjshëm që në vendin tonë ekzistojnë shumë mekanizma ligjorë që kanë adresar këto problematika tashmë.

Nuk po kthehem te regjistrimi, a e gjejmë dot në gjykatë apo jo, sepse më duket paksa e ezauruar.

Për sa i përket Kushtetutës sonë të mos harrojmë se po bëni një keqinterpretim të saj, sepse thotë: “Mund të rregullojmë mediet dhe jomediet”. Nuk nënkupton mediet përmes frekuencave. Frekuenca është një e mirë publike që zotërohet dhe rregullohet nga shteti. Për këtë është ngritur AMA dhe është funksioni i saj parësor. Por nuk nënkupton në asnjë moment tjetër rregullimin e medias dhe për më tepër vlerësimin e përmbajtjes.

Nëse mediet *online* do të përdornin një të mirë publike siç janë frekuencat, atëherë do të duhej që të licencoheshin, jo vetëm të regjistroheshin, ndërkohë parafolësja tha: “Në asnjë mënyrë ne nuk mund të bëjmë licencimin dhe dhënien e lejes për hapjen e medieeve”. Pra, nuk kam përshtypjen se jemi vetëm ne të paqartë për këtë gjë. Ne jemi shumë të qartë, por t'i shikojmë të dyja anët.

Për sa i përket vetërregullimit, ky i fundit synon pikërisht këtë gjë, synon një mekanizëm të ndërmjetëm ku njerëzit mund të ankohen dhe mund të gjejnë të drejtën e tyre pa iu dashur t'i futen sistemit gjyqësor.

Për sa i përket asaj, se sa zgjasin proceset gjyqësore te ne, për këtë gjë, kam përshtypjen se duhet të ketë një takim tjetër të këtij komisioni. Ndoshta mund të gjenden zgjidhje më efikase që njerëzit t'i mbarojnë pak më shpejt procedurat e tyre gjyqësore. Por nuk besoj se mund ta zgjidhim përmes këtyre dy projektligjeve.

Deri tani kanë funksionuar, jemi ndër vendet e vetme që e kemi të parashikuar shpifjen edhe në Kodin Civil edhe në Kodin Penal. Pra, nuk besoj se ka vend për përmirësim.

Për sa u përket sugjerimeve konkrete, kam përshtypjen se këtu vazhdon një keqkuptim shumë i madh. Jua thamë se qëllimi dhe kundërshtia jonë kryesore ka qenë lidhur me kontrollin dhe censurimin e medias nga dy institucione publike që janë AMA dhe AKEP-i. Kthehemi pas. Si mund të jemi konstruktivë në dy projektligjet që janë rishikim i ligjit për AMA-n dhe AKEP-in, por duke mos dashur këto dy institucione që ta rregullojnë? Doni të bëni një ligj për vetërregullimin, se si mediet duhet të krijojnë mes vetes një komision etike ku t'iu përgjigjen ankesave të qytetarit? Po! Por ky është një ligj tjetër, nuk është rishikim i ligjit të AMA-s dhe rishikim i ligjit të AKEP-it. Pra, ne kthehemi te i njëjti diskutim. Ne nuk jemi konstruktivë, sepse nuk japim komente konkrete për nene të posaçme, për rishikimin e ligjeve të të dy institucioneve të cilat janë politikisht të zgjedhura, politikisht të kontrolluar dhe janë institucione publike. Në asnjë vend tjetër nuk bëjnë kontrollin e përmbajtjes së medias.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, bëhet edhe nga gjykata.

Ulsi Manja - Zoti Hyseni, ndizeni mikrofonin!

Aleksandër Çipa - Pretendimin tonë të parë, të shprehur përmes deklarimeve për mosheqjen e mundësisë për t'iu drejtuar gjykatës, ju e keni korrigjuar, por e keni korrigjuar në një mënyrë jofunksionale për mediet. Ju thoni në projektligj se AMA merr vendimin e penalizimit për rastet e ankesave dhe pala ka të drejta që ta çojë në gjykatë. Ndërkohë që në letrën që ju ka dërguar dje përfaqësuesi i lartë i OSBE-së, në mënyrë të posaçme kërkon që të mos merret ky vendim: “AMA të mos e marrë vendimin pa u shprehur gjykata, se nëse një medieje *online* ju do t'ia merrni me vendim, do t'ia hiqni atë mungesë financiare, ajo nuk mund të ekzistojë më, pasi i jepet penalteti. Kjo është që ta çosh në faliment politik apo jopolitik. Kjo nuk është e drejtë. Nuk mund të merret i mirëqenë një vendim i AMA-s, i cili do të shkojë në gjykatë. Por pa u shprehur gjykata, ti nuk mund ta ekzekutosh atë. Në projektligj është kjo gjë dhe është e gabuar. Meqenëse doni detaje, por të jemi të sinqertë ka shumë nene të tjera të diskutueshme. Prandaj ne mbajmë një qëndrim dhe krijojmë evazivitete nëse ju na pyesni për detaje. Ne ju japim kaq shumë detaje, të cilat janë të mjaftueshme për të besuar se këto dy projektligje janë të refuzueshme.

Ulsi Manja - Po, zoti Hyseni!

Alket Hyseni - Ky ishte rasti i parë që vlen për ne, kur ju u orientuat në ligj, kur thatë se aksesimi në gjykatë kufizohet, sepse pagesa e penaltetit paraprakisht apo ekzekutimi i vendimit të organit administrativ apo gjyqësor që është bordi, pamundëson apo mund t'i

pamundësojë teorikisht një subjekti aksesin në gjykatë. Kjo mund të vlejë. Sugjeroj bashkë me relatoren ta mbajmë shënim.

Aleksandër Çipa - Po rasti i gjobave, i penaliteteve financiare?

Alket Hyseni – Këtë po themi, mund ta shikojmë që derisa të marrë vendim gjykata, ky vendim të mos ekzekutohet. Ky është një shqetësim real juaji. Do ta shikojmë, nëse ka bazë reale në praktikë. A mund të kategorizohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- ... para se të shprehet autoriteti gjyqësor.

Alket Hyseni -...apo mund të vlejë *unblock* për të gjitha subjektet që të mos ekzekutohet deri në fund të shqyrtimit gjyqësor. Unë doja më konkretisht, sepse vlen për ne dhe na ndihmon.

Aleksandër Çipa - Më konkretisht, nga mund të vijë ai që ne e quajmë rreziku i censurimit dhe i indulgjencës politike mbi mediet? Vjen nga Këshilli i Ankesave. Ky i fundit është një organ brenda institucionit të AMA-s. AMA është një ent rregullator, por atributet për krijimin dhe administrimin e këtij enti rregullator kush i ka? Mos i kanë mediet, gazetarët, grupet e interesit? Jo! E ka një pushtet. Kjo është çështja.

Alket Hyseni - Mund të rregullojmë këshillin e ankesave që ju të keni përfaqësuesit tuaj?

Aleksandër Çipa - Natyrisht që po.

Propozimin që bëri kolegja për përfshirjen në legjislacion të termit “për një ent etike” është shumë i rëndësishëm, sepse në këtë rast kontributi nga projektligji vjen edhe për një vetërregullim nga brenda, nga institucioni, nga enti, por edhe vetërregullimi që lidhet nga komuniteti dhe spektrit medial i vendit. Kjo është çështja. Këto nuk parashikohen në këto dy projektligje dhe janë propozime të mjaftueshme për ta kuptuar që këto meritojnë këtë refuzim që ne iu kemi bërë.

Ulsi Manja - Zoti Çipa e thamë që në fillim se këto seanca dëgjimore zhvillohen në frymën e përmirësimit të projektligjit. Nuk është qëllimi të kufizojmë asnjë të drejtë, përkundrazi të gjejmë balancat e duhura për t'i rregulluar siç duhet këto të drejta.

Ka pyetje të tjera?

Megi Ndregjoni – Pyetja që kam unë është: pse është e nevojshme të vendosim dy organe administrative për t'ua lehtësuar punën qytetarëve, kur qytetarët fare mirë mund të shkonin në gjykatë? Ne shtojmë atë që ju si juristë duhet ta njihini, hallkën shtesë, duke mos i shërbyer ekonomisë gjyqësore, nëse do t'i referohemi edhe kuadrit të reformës në drejtësi, ku ky ishte një nga parimet.

Duke qenë se ne e kemi të rregulluar shpifjen, ndërhyrjen në jetën private dhe të gjitha problematikat në legjislacionin penal, kemi detyruar edhe se çfarë mund të marrë gjykata në Kodin Penal, pra detyrim për të publikuar një vendim gjyqësor ku një nga pala e paditur apo e kallëzuar mund të jetë një medie. Pse është e rëndësishme të futet AMA, AKEP-i për të realizuar atë që fare mirë mund ta bëjë gjykata?

Nëse ju mendoni se gjykata është e paaftë dhe nuk ka mundësi, pse nuk e mendoni që të ketë një rregullim në Kodin Penal, në Kodin e Procedurës Penale, në Kodin e Procedurës Civile, po duhen të krijohen dy projektligje të tilla për të censuruar mediet?

Klodiana Kapo – Ky projektligj apo ky draft ka ardhur në tavolinë si një kërkesë për të rregulluar pjesën e dezinformimit *fake news* dhe propagandës.

Ju pak më parë thatë se keni shumë ankesa të qytetarëve për sa u përket këtyre 3 çështjeve. Do të ishte shumë me vlerë të dinim se sa është numri i këtyre ankesave dhe ku kanë shkuar?

Me sa dimë ne AMA është një institucion, i cili ka në funksion të tij, Këshillin e Ankesave, që të merret se ku është shkelur kodi i etikës, si është shkelur. Është e parashikuar në ligj, se cilat janë masat dhe gjrobat. A është zbatuar deri tani? Si është zbatuar?

Pak më parë pohuat dhe thatë se institucionet si gjykata po hasin vështirësi në zbatimin e ligjit. Jeni duke diskutuar për një draftligj për t'ia dhënë një institucioni që deri tani funksionon apo jo? Sipas indikatorëve që ju, ne kemi na rezulton se nuk dimë ende sesa është numri i ankesave të qytetarëve shqiptarë, të paktën për mediet kombëtare, të cilat kanë brenda profilit të tyre për të rregulluar apo vetërregulluar.

Jemi duke diskutuar një projektligj, i cili nuk dimë sesa i përfshin të gjitha mediet *online* dhe aty ku bëhet fjalë për propagandë. Të gjithë ne gazetarët, por edhe ju, e dini shumë mirë se gjatë këtyre viteve në televizionet shqiptare, por edhe në portalet *online* transmetohen mesazhe apo video që prodhohen nga institucionet publike opozitare, pra nga të gjitha institucionet. Në gjuhën e gazetarëve kjo është propagandë. Në këtë draft ne nuk e dimë se sa pasqyrohet dhe si do të kontrollohet.

Ulsi Manja - Ka pyetje të tjera?

Ju lutem merrni fjalën dhe prezantohuni!

Edmond Petraj - Vij nga radhët e avokatëve penalistë. Është kënaqësi që marr pjesë në një debat të tillë, pasi multimedien shpresoj se e njoh mirë. Dhe duke e parë nga jashtë saj shikoj se mënyra sesi kanë funksionuar mediet në Shqipëri është një themel shumë i gabuar. Këtu është ndërtuar në rrënoja një medie. Më pas dua të vazhdoj me disa gjëra lidhur me komisionin e disiplinës, se si mund të ndërtohet që qytetari të çojë një ankesë, pra me AMA-n.

Mendoj se ligji i AMA-s nuk ka nevojë për arnime, por ka nevojë që të bëhet një ligj i ri nga fillimi. Të gjithë e dimë se frekuencat kombëtare janë përdorur shumë keq për 30 vjet, janë përdorur për interesa të ngushta, por ata që e paguajnë janë pjesa që punojnë aty. Gjithashtu, mënyra e digjitalizimit, për mendimin tim, është shumë e keqe, sepse, kur iu dha e drejta një personi që kishte një frekuencë, ai duhej të merrte edhe zbërthimin e një frekuence UEF dhe ta kalonte në dixhitalizim. Pra, i njëjti pronar, i cili nuk ka pasur mundësi të ndërtonte një medie, ka ndërtuar 8 kanale dhe vazhdon të ndërtonte kanale të tjera, më pas ky i ka shitur, duke i bërë milionerë pronarët e medias. Pra, flasim gjithmonë për institucionin përgjegjës, që është AMA, apo si është quajtur ndryshe dikur, që për 30 vjet ka funksion politik dhe aspak bashkëpunues me operatorët multimedialë që janë sot në treg. A është bërë ndonjëherë ballafaqim midis AMA-s dhe grupeve të interesit? Asnjëherë! Pra, asnjëherë nuk kanë qenë në përballje, sepse AMA nuk ka një këshill kombëtar. Cili është këshilli kombëtar i AMA-s?! Unë nuk e di. Unë jam një monitorues i mirë i medieve dhe e di që AMA nuk ka një këshill kombëtar, ku të gjithë përfaqësuesit, jo pronarët e medieve, të jenë zëri i lirë i gazetarëve. Gjithashtu, duhet rregulluar edhe statusi i gazetarëve, sepse një gazetar pa status është i rrezikuar të pronari i medias ku punon. Unë mendoj se kjo është gjëja më kryesore për të kaluar më pas tek AKEP-i, si forma më e mirë e regjistrimit. E gjitha kjo është një e drejtë, sepse çdo person që ka një domen, duhet të regjistrohet, ku të paraqesë edhe logjikën e NIPT-it, programin e tij dhe çfarë misioni ka portali i tij.

Ky projektligj në të ardhmen do të hapë shumë probleme dhe do të ketë shumë përplasje, sepse Kodi Penal, Kodi Civil dhe Kodi Administrativ i kanë të rregulluara disa funksione. Kështu që një qytetar, në momentin që identifikon dikë, ai mund ta çojë shumë mirë në gjykatë vetë institucionin dhe të kërkojë dëmshpërblimin apo të drejtën nëpërmjet gjykatës. Ajo që unë dua të them, është se komisioni i disiplinës që duhet ngritur tek AMA, jo ky që është aktualisht, duhet të jetë një komision i pavarur. Pra, i gjithë thelbi është te komisioni i disiplinës, te forma se si e pret ankesën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk e di se si quhet.

Një ankesë ose duhet të marrë një emërtim ose duhet të ketë një logjikë, në mënyrë që të merret një vendim i përbashkët, ku personit, të cilit i është drejtuar ankesa, t'i kërkohej një deklaratë. Pra, pasi depozitohet një ankesë, komisioni duhet ta vlerësojë dhe t'i kërkojë personit, i cili është ndëshkuar në këtë rast, një informacion me anë të një deklarate se sa qëndron kjo ankesë. Ju duhet të më kuptoni në këtë rast, sepse, nëse rregullohet kjo gjë, do të ketë më shumë rregullime në problematikat që do të hapë projektligji, pasi të shqyrtohet dhe të

identifikohet personi. Për shembull, shkrimi i një portali *online* i pëlqen dikujt tjetër dhe e poston në faqen e tij, por ky shkrim e ka burim apo jo. Pra, nuk duhet ndëshkuar pronari apo ai që ka portalin, por duhet gjetur burimi se nga ka ardhur ky shkrim. Unë mendoj se pjesa e burimit është shumë e rëndësishme. Kështu që vendimi që do të marrë ky komision është shumë esencial. Unë mendoj se këtu fillon problematika, sepse gjykatat janë shumë të ngarkuara me gjyqe që kanë 5 apo 10 vjet dhe që nuk kanë mbaruar ende, ndaj ne nuk duhet t'i mbushim gjykatat me këto gjëra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e drejta e tij, por gjykata duhet të jetë shkalla e fundit. Pra, pa u shqyrtuar mirë në komision, nuk duhet t'i jepet e drejta të ankohet në gjykatë. Ky është mendimi im për këtë dhe duhet t'i jepet prioritet një portali me një lajm të botuar. Po e përsëris: nuk është gazetari ai që e ka prodhuar atë lajm, sepse ndoshta ka edhe mendime apo arsyetime të ndryshme për situatën për një person dhe një portal që e ka botuar, por ajo ka në burim reference, pra burimi është kryesori. Unë mendoj se kjo gjë duhet parë me kujdes dhe jo të ndëshkohen këto portale.

Dua të ndalem pak te media e lirë. Në medien e lirë nuk mund të futet edhe një pasionant, i cili mban një portal edhe nga telefoni. Unë kam disa shokë, të cilët mbajnë portale nga telefoni dhe nuk e kanë fare problem të bëjnë edhe medie *online* aty, por kjo nuk do të thotë se këto medie duhet të abuzojnë. Kjo nuk ka lidhje, por duhet të shikohen dhe të dallohen në ligj institucionet që përfitojnë apo që abuzojnë me këto portale. Unë shikoj gazetarë këtu, të cilët i kam parë në medie (ndihem shumë mirë, sepse me Sandrin njihemi më herët), por këta janë direkt të ndëshkuar, sepse këta gazetarë kanë një medie *online*. Këtu mendoj se është edhe thelbi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Petraj!

A kanë të ftuarit ndonjë gjë për të shtuar?

Po, zoti Alimadhi, për procedurë.

Adriatik Alimadhi - Në fakt, zoti kryetar, të gjitha diskutimet këtu janë objekt i komisionit të medias. Në qoftë zoti Çipa e ka tërhequr deklaratën që bëri këtu, sepse ju këtë marrëdhënie e suportoni shumë mirë, duke i bërë palët që të tërhiqen, hajdeni të procedojmë për sa i përket...

Aleksandër Çipa – Zoti Deputet, ne nuk jemi tërhequr.

Adriatik Alimadhi – Prisni të mbarojë, ju lutem!

Ulsi Manja - Prisni ta mbarojë, sepse e ka për procedurë.

Adriatik Alimadhi - Madje u nisët, sepse thatë që do të dakordësohemi dhe jeni gati të përballeni e të tjera, ju sapo e thatë. Megjithatë, unë, si anëtar i Komisioni të Ligjeve, për

procedurë, po ju them se çfarë i përket rendit të ditës së Komisionit të Ligjeve jemi të gatshëm ta zhvillojmë, por, ju lutem, të gjitha debatet që po bëjmë këtu i përkasin Komisionit të Medies.

Ulsi Manja - Ju lutem!

Adriatik Alimadhi – Të mos e bëjmë tani pazar Roskoveci.

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi, këtë e kanë vendosur Konferenca e Kryetarëve dhe seanca plenare! Komisioni i Ligjeve as më shumë dhe as më pak zbaton një vendimmarrje të Konferencës së Kryetarëve dhe të Kuvendit të Shqipërisë. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe, sigurisht, bëjmë oponencë ligjore të këtyre dy projektligjeve, sepse komisioni teknik, për sa kohë flitet për lirinë e medieve, është Komisioni i Medieve, por oponencën ligjore më mirë sesa në këtë komision nuk mund ta bëjë asnjë komision tjetër i Kuvendit, aq më tepër që në përbërje të këtij komisioni është edhe Nënkomisioni për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Kështu që, të nderuar kolegë, kush ka ndonjë merak të fundit lidhur me thelbin e diskutimit?

Aleksandër Çipa - Zoti Kryetar, kam përshtypjen se u krijua një keqkuptim për qëndrimin tonë këtu.

Ulsi Manja - Po, zoti Çipa.

Aleksandër Çipa - Ne i përmbahemi asaj deklaratë që kemi bërë në momentin e parë të komunikimit me ju. Ne u futëm në diskutime të çështjeve të ligjit për t'ju dhënë të kuptoni se ne jo vetëm që jemi të vëmendshëm dhe i ndjekim me përgjegjësi maksimale, për llogari të atyre që përfaqësojmë dhe për llogari të opinionit publik, por, gjithashtu, i përmbahemi deklaratës, nëse këto dy projektligje nuk kthehen. Nga ana tjetër, nëse nuk merren në konsideratë ato vërejtje substanciale që kemi përcjellë ne, atëherë nuk jemi dakord dhe nga ky moment unë u kërkoj kolegëve të largohemi.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Po zonja Voko.

Kristina Voko - Këtu u diskutua për mediet *online* dhe besoj se këtë diskutim e kemi ezauruar me faktin se ju nuk ishit të sigurt në përgjigjen tuaj që në seancën e datës 25, nëse janë përjashtuar versionet *online* të gazetave apo jo dhe këtu ka ende shumë paqartësi. Megjithatë, sa prekemi ne dhe sa të vëmendshëm jemi ndaj shkeljes së të drejtave të individëve, ndaj shpifjes, ndaj dinjitetit personal e kështu me radhë, nëse ky do të ishte qëllimi kryesor i ligjit, ju siguroj se ai do të bënte të mundur mbrojtjen e dinjitetit të qytetarëve edhe ndaj shpifjes së politikanëve, por këtë gjë ky ligj e përjashton. Po ashtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Alimadhi, të mbarojnë kolegët!

Kristina Voko - Po ashtu, të mund ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, keni të drejtë kjo është hyrja, qëndrimi është i drejtpërdrejtë, ndaj, ju lutem, kini më shumë respekt për mediet dhe nuk mund t'ju drejtoheni asnjë medieje me termin "kazan". Unë e di që nuk e kishit për ne këtu dhe bëtë përjashtime, por ky është një ndër shqetësimet kryesore dhe është një ndër termat pexhorativë që po përdoret përherë e më shumë dhe që është e pafalshme për këdo që ka një post zyrtar, i cili e përdor, pa dhënë shembuj konkret, dhe, nëse ka kundërshtime të caktuara, mund t'ju çojë ato në gjykatë. Ju lutem, ky ka qenë një ndër shqetësimet me të cilat Shqipëria tashmë ka humbur shumë pikë në organizatat ndërkombëtare për sa i përket lirisë së medias dhe respektimit të lirisë së gazetarëve. Ky është një ndër shqetësimet kryesore të ngritura nga të gjitha organizatat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut përkundrejt Shqipërisë, si dhe shqetësimi kryesor, i cili iu është adresuar juve si shtet në *database-in* e Këshillit të Europës dy ditë më parë për sulmet verbale që iu bënë medias lidhur edhe me tërmetin, ku u është kërkuar llogari, sepse është quajtur shkelje e të drejtave. Kështu që, kur flasim, duhet të jemi jashtëzakonisht shumë të kujdesshëm. Sigurisht, e thanë kolegët që duhet të jemi të ndërgjegjshëm që ka nevojë për një vetërregullim. Ne jemi të ndërgjegjshëm, pasi në çdo profesion ka shkelje, ka gabime, por duhet gjetur një mënyrë për t'ju rregulluar. AMA dhe AKEP-i nuk janë institucionet e duhura për ta bërë këtë gjë, sepse janë politikisht të kontrolluara. Pra, nuk ka një raport ndërkombëtar dhe një vlerësim ndërkombëtar, qoftë ato që lidhen me gjendjen e medieje, qoftë edhe deri tek ODIHR-i që të thonë se AMA dhe AKEP-i janë institucione të pavarura. Tani, t'ju varim mëlçitë në qafë ujkut më duket e pamundur. Unë e kuptoj që ju doni gjëra konkrete dhe konkrete është se nuk duhet të jetë rishikimi i ligjit të AMA-s dhe AKEP-it. Hajdeni të gjithë së bashku të mendojmë nëse duhet të bëjmë një ligj i ri, i cili të rregullojë dhe të adresojë shumë problematika, duke përfshirë këtu edhe propagandën, edhe fyerjet që individët, mediet dhe gazetarët si individë marrim nga politikanët! Hajdeni t'ju adresojmë të gjitha bashkë dhe për këtë do të jemi shumë të hapur!

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Me sa dëgjova, bashkohem me të gjithë kolegët. Është kënaqësi që sot kemi gazetarë në komision, por, kur flitet për vetërregullim, ju ende nuk e keni një kod etike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E keni!

A e keni ligjin e statusit të gazetarit?

Aleksandër Çipa – Madje, zoti Kryetar, jo vetëm që e kemi, por Kodi ynë i Etikës përfshin edhe mediet *online*.

Ulsi Manja - A e zbatoni ju Kodin e Etikës?

Aleksandër Çipa – Natyrisht, ajo është pjesë e ndërgjegjes individuale.

Ulsi Manja – Po ligji për statusin e gazetarit a keni sot?

Kristina Voko – Jo, nuk e kemi për statusin e gazetarit dhe asnjë nga organizatat nuk është këtu për statusin e gazetarit.

Ulsi Manja - Në rregull!

Kristina Voko – Gazetaria nuk duhet të jetë një profesion i rregulluar që do të thotë se duhet t’i jepet një licencë gjithkujt që ka mundësi ta bëjë këtë profesion, pra gjithkujt që mund të ketë një zë dhe një opinion në këtë vend. Janë shumë pak vende ato që e kanë këtë profesion të rregulluar dhe kanë marrë vërejtje të jashtëzakonshme. Duhet të ketë parashikim për një mbrojtje të posaçme për profesionin e gazetarit, por nuk mund t’i thuhet askujt që ti bën apo nuk bën për të qenë gazetar.

Ulsi Manja - E mira është që të kemi një mekanizëm rregullimi për mbrojtjen e gazetarëve.

Kristina Voko – Duhet të respektohet Kodi i Punës për mediet dhe besoj se kjo mjafton.

Ulsi Manja – Në rregull! Pra, të respektohet Kodi i Punës dhe gazetari të ketë garanci në ushtrimin e profesionit.

A ka nga të ftuarit për të shtuar diçka dhe nëse nuk ka...

Po.

Viola Keta - Për hir të transparencës unë jam Viola Keta dhe jam redaktore në portalin “Faktoje.al”. Unë jam gazetare prej 20 vjetësh dhe kështu që kam një arkiv shumë të mirë dhe mbaj mend shumë gjera. Për transparencë, dua të them se zonja Klotilda Bushka tha se ishte e shqetësuar se shumë qytetarë mund të mbeten pa e përfunduar procesin për shkak se nuk identifikon dot se cilat medie *online* kanë bërë një shpifje. Në fakt, zonja Klotilda, unë e vë pak në dyshim këtë gjë, sepse mbaj mend shumë mirë se iniciator për ligjin antishpifje është Kryeministri, Edi Rama, i cili e shpalli këtë fiks një vit më parë në një darkë butaforike, ku kishte ftuar edhe gazetarë të huaj. Në fakt, ai bëri shumë mirë, sepse duhej bërë një ligj antishpifje, por mënyra dhe forma që ka përdorur mendoj se janë të gabuara. Ndërkohë, është vetë Kryeministri ai që duhet të japë shembullin e një njeriu që respekton etikën, sidomos ndaj mendimeve të tij për vendin të tij, por, në fakt, është ai i pari që e shkel. Ne të gjithë e dimë se si u drejtohet ai medieve, duke i quajtur ato “kazan” dhe shumë etiketime të tjera. Kështu që

unë mendoj se ky është modeli i mbivendosjes së roleve, pra, duke mos pasur të drejtë të shkojmë në gjykatë, ne u japim të drejtën dy organizmave të tjerë, siç janë AMA dhe AKEP-i të marrin vendime. Unë mendoj se kjo është një gjë shumë e gabuar, sepse ky rol u duhet lënë organizmave që e kanë për detyrë ta bëjnë këtë gjë, që janë gjykatat, dhe të presim që ato të japin shembullin më të mirë të mundshëm. Më pas duhet të shikojmë nëse gjykata do të jetë e aftë që të japë modelin e saj, atëherë le të kalojmë te modelet e tjera. Unë mendoj se nuk po u jepet koha dhe mundësia institucioneve të bëjnë detyrën e tyre dhe mendoj se është më shumë një revansh sesa vërtet një shqetësim real i Kryeministrit, i qeverisë dhe juaji për ta përmirësuar situatën.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Të lutem, një sekondë!

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Keta, unë jam dakord me shqetësimin që ju përcillni për thelbin e projektligjeve, por nuk ndaj të njëjtin mendim me pjesën e fundit të fjalës që thatë për revansh kundër medieve, sepse, nëse do të ishte kështu siç mendoni ju nuk do të kishim këtë diskutim të gjerë dhe këto seanca dëgjimore në Komisionin e Ligjeve. Ju duhet të keni parasysh faktin se projektligjet janë depozituar në Kuvend në korrik të vitit 2019 dhe ne sot jemi në muajin dhjetor dhe janë bërë 6 muaj diskutime dhe punë konkrete për këto dy projektligje, ndaj unë nuk e konsideroj revansh, por qëllim i mirë për t'i përmirësuar këto drafte. Patjetër që Kryeministri është iniciatori i këtyre dy projektligjeve, se këto dy projektligje janë të maxhorancës dhe Kryeministri i vendit është kryesuesi i kësaj maxhorance, ndaj edhe ligjet janë produkte të një vullneti të caktuar politik që në atë moment, kur miratohen, reflektojnë maxhorancën në Kuvendin e Shqipërisë. Kështu kanë vendosur shqiptarët në qershor të vitit 2017 dhe askush nuk ia heq këtë të drejtë as Kryeministrit, as maxhorancës, as çdo deputeti të Kuvendit të Shqipërisë apo 20 mijë qytetarëve, të cilët kanë të drejtë të propozojnë nisma ligjore të caktuara. Kështu që unë nuk mendoj se ky është thelbi i shqetësimit që duhet të keni ju si përfaqësuese e medieve.

Viola Keta - Unë kam vetëm një argument për atë që thashë, se jam një njeri që mbaj përgjegjësi për ato që them. Lidhur me revanshin, dua të jap një argument.

Ulsi Manja - Jo, nuk ka asnjë argument, sepse ju u morët me politikë në pjesën e parë të fjalës, kurse pjesa e dytë ishte reflektimi i atij shqetësimi që kishit.

Viola Keta - Në fakt, ne jemi në një komision dhe absolutisht që ky është një diskutim politik, sepse politika është ajo që ka marrë një vendim...

Ulsi Manja – Po, mund të anëtarësohesh në një parti politike dhe jeni e lirë të vini këtu dhe të bëni diskutime politike.

Viola Keta - Unë jam aty ku mendoj se bëj punën time më mirë. Unë jam një gazetare, por, meqenëse ra fjala te revanshi, unë do t'ju përmend vetëm rastin e fundit. Zoti Kryeministër, nëpërmjet kanalit të tij ERTV, ka akuzuar mediet se janë vrasëse, sepse kanë detyruar ...

Ulsi Manja - Ju lutem, sepse ka qenë një nivel i lartë diskutimi dhe mua më vjen keq ta ulim nivelin e debatit.

Viola Keta - Atëherë, unë mund t'ju them vetëm kaq: një Kryeministër që akuzon për vrasje, pra merr rolin e prokurorit, minimalisht, duhej të kishte autorësinë e atij personi që ka vdekur dhe duhej t'i vërtetonte mediet para se ta akuzonte, se ka vrarë dhe në bazë të cilave provave. Pra, ky është modeli.

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Petraj, zonja Keta!

Viola Keta – Po, ka medie të papërgjegjshme, por duhet vërtetuar pse janë ato të papërgjegjshme dhe cilat janë provat. Ky është modeli më i mirë që përcjell politika.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja - Ju lutem, a ka dikush nga të ftuarit për të shtuar diçka që ta mbyllim këtë seancë dëgjimore?

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Çipa, e ka kërkuar edhe njëherë fjalën, pasi të bëni ju mbylljen.

Mevlut Derti – Quhem Mevlut Derti nga Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë. Atëherë, unë nuk do të bie në përsëritje, por dua të shtoj te Këshilli i Ankesave se është e rëndësishme që të ketë pjesëmarrje shumë të mirë me qëllim që të hiqet burokracia e kohës nëpër gjykata.

Së dyti, te neni 133, penalteti financiar, duhet të bëhet ndryshimi i paragrafit të fundit, ku thuhet: “Subjekti nuk do të përfitojë lehtësira fiskale apo të ndonjë lloj tjetër për një periudhë 3-vjeçare.”. Pra, edhe kjo duhet parë për t'u përmirësuar rreshti i fundit, për vetë faktin se unë jam dakord që operatori do të sanksionohet, por pas vitit të dytë ose të parë ai mund ta përmirësojë atë që ka shkaktuar, pra edhe kjo ka nevojë për rregullime dhe përmirësime.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Derti!

Ju lutem, zoti Çipa, në emër edhe të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile, a do të bëni një komet të fundit?

Aleksandër Çipa – Konkluzioni është se ju jeni të lumtur për këto dy projektligje, kurse ne jemi të brengosur.

Ulsi Manja - Shumë faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Lëreni ta përfundojë mendimin!

Aleksandër Çipa – Në fjalën që mbajti pak më parë zoti kryetar tha: “Unë jam i lumtur që janë këto dy projektligje” dhe unë nuk gaboj, sepse jam reporter i vjetër në këtë profesion dhe po i referohem në mënyrë eksplicite deklaramit të kryetarit, prandaj them se në këtë pikë na ndan lumturia.

Ulsi Manja – Na ndan lumturia, por mund të jetë edhe lumturi e përbashkët.

Faleminderit për prezencën sot në komision.

Të nderuar kolegë, do të bëjmë 10 minuta pushim për të vazhduar më pas me seancën dëgjimore me Dhomën e Tregtisë dhe shoqatat e biznesit.

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.12.2019, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me përfaqësues të dhomës së tregtisë dhe shoqatat e biznesit, në kuadër të shqyrtimit të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Damian Gjikhuri, Bashkim Fino, Elena Xhina, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Përmeti, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti, Alban Zeneli, Ediola Braha, Nikolin Staka dhe Artemisa Malo

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Xhevit Hysenaj - Drejtor i Alb Kalustyan Managing

Filip Gjoka - Kryetar i Industrisë së Bimeve dhe Erëzave të Shqipërisë

Drini Shkreli - Administrator i Eurofish sh.p.k

Ulsi Manja – Rifillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Kjo pjesë e dytë e mbledhjes është vazhdim i seancave dëgjimore për dy projektligje shumë të rëndësishme, ato që quhen “paketa antishpifje”, projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”” dhe projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relatorë vazhdojnë të jenë zonja Bushka dhe zonja Hysi.

Në pjesën e parë zhvilluam një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, ndërsa në këtë seancë dëgjimore të radhës me dhomat e tregtisë dhe shoqatave të biznesit, janë bashkuar në Komisionin e Ligjeve edhe kolegët e Komisionit të Edukimit dhe Informimit Publik, që është komision përgjegjës për shqyrtimin e këtyre dy projektligjeve. Rregullorja e Kuvendit na mundëson që seancat dëgjimore apo mbledhje të caktuara t’i bëjmë të përbashkëta me komisionin përgjegjës. Natyrisht, komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe do të bëjë një oponencë ligjore të këtyre dy projektligjeve, për sa i përket përputhshmërisë me Kushtetutën, kuadrit ligjor apo standardeve ligjore të Bashkimit Europian, ndërsa komisioni përgjegjës do ta shqyrtojë projektligjin edhe në aspektet teknike.

Sipas njoftimit të datës 6 dhjetor, janë njoftuar dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit, konkretisht: Shoqata Shqiptare e Bankave; presidenti i “Biznes Albania”; kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë; kryetari i Dhomës së Fasonistëve të Shqipërisë; kryetari i Dhomës së Tregtisë në Dibër; kreu i Shoqatës Shqiptare të Turizmit; Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar; Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë; sipërmarrës të biznesit ushqimor; sipërmarrës në fushën e sigurimeve; sipërmarrës në industrinë përpunuese; sipërmarrës në industrinë e prodhimit të këpucëve; sipërmarrës në ndërtim; sipërmarrës në industrinë e peshkimit; të bimëve medicinale; sipërmarrës në inxhinieri dhe infrastrukturë; Shoqata Nordike e Tregtisë dhe Biznesit; Dhoma Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë; Dhoma Zvicerane e Industrisë dhe Tregtisë, si dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, por kanë konfirmuar pjesëmarrjen për sot në këtë seancë dëgjimore, zoti Xhevit Hysenaj, drejtor i Alb Kalustyan Managing, zoti Filip Gjoka, kryetar i Industrisë së Bimëve dhe Erëzave të Shqipërisë dhe zoti Drini Shkreli, administrator i Eurofish sh.p.k.

Nga këta që kanë konfirmuar pjesëmarrjen, a kemi ndonjë prezent? Nuk kemi.

Kjo do të thotë se shoqatat e biznesit dhe dhomat e tregtisë janë të kënaqura me dy projektligjet që po diskutojmë në Komisionin e Ligjeve. Ndoshta e kanë lënë të jenë prezentë

në seancën dëgjimore që do të zhvillojë komisioni përgjegjës, që është Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik.

Duke qenë se nuk kemi prezentë përfaqësues nga dhomat e tregtisë dhe shoqatave të biznesit, në emër të kolegëve të të dy komisioneve, të Komsionit të Ligjeve dhe Komsionit të Edukimit dhe të Informimit Publik, nuk më mbetet gjë tjetër veçse ta deklaroj të mbyllur mbledhjen e Komsionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Shumë faleminderit për prezencën dhe durimin!

Mbledhja e radhës dhe rendi i ditës do t'ju njoftohen nëpërmjet postës elektronike.

MBYLLET MBLEDHJA